



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

**UDHËZUES PËR ZBATIM TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE ME BAZË
NË SHKOLLË**

Prishtinë, shkurt 2022

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
1. Hyrje	6
Përkufizimi për zhvillimin profesional me bazë në shkollë dhe parimet udhëheqëse...	7
2. Zhvillimi profesional i mësimeve me bazë në shkollë, bazuar në kornizën ligjore dhe politikat arsimore	9
2.1. Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë	9
2.2. Korniza për Sigurimin e Cilësisë të Performancës së shkollës.....	10
2.3. Udhëzimi administrativ 04/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar	12
2.4. Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimeve në Kosovë	12
2.5. Udhëzimi administrativ 05/2017 për sistemin e licencimit dhe zhvillimit të mësimeve në karrierë.....	14
2.6. Udhëzimi administrativ nr. 14/2018 mbi vlerësimin e performancës së mësimeve	16
2.7. Udhëzimi administrativ nr. 06/2017 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillimin profesional të mësimeve dhe punonjësve arsimorë.....	17
2.8. Udhëzimi administrativ nr. 119/2020 mbi zhvillimin profesional të mësimeve me bazë në shkollë.....	17
3. Format e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë	19
4. Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPMBSH	20
5. Procedurat e brendshme të zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë	24
5.1. Informimi dhe sensibilizimi i mësimeve për mundësitë dhe kërkesat e zhvillimit profesional.....	24

5.2. Analiza e kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimeve në nivel shkollë	26
5.3. Mbledhja e të dhënave - identifikimi dhe vlerësimi i nevojave	26
5.4. Përcaktimi i prioriteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë	29
5.5. Planifikimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë	30
5.6. Zbatimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë	31
5.7. Monitorimi i brendshëm i aktiviteteve të ZHPBSH	35
5.8. Raportimi i aktiviteteve të ZHPBSH	35
5.9. Certifikimi me bazë në shkollë	36
6. Procedurat e jashtme - përkrahja e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë	37
6.1. Mbështetja e ZHPBSH.....	38
6.2. Monitorimi.....	39
6.3. Verifikimi	41
6.4. Vlerësimi.....	42
7. Procedurat dhe kriteret e certifikimit të ZHPBSH	43
8. Strukturat mbështetëse të ZHPBSH	45
8.1. Strukturat mbështetëse në nivel shkollë.....	45
8.2. Strukturat mbështetëse në nivel komunal	52
8.3. Strukturat mbështetëse në nivel qendror	53
Shtojcat: Instrumentet për realizimin e ZHPBSH	56
Shtojca 1: Pyetësor për vlerësimin e nevojave të zhvillimit profesional të mësimeve	56
Shtojca 2: Model i një plani individual për zhvillim profesional me bazë në shkollë...	61
Shtojca 3: Model i planit vjetor të zhvillimit profesional me bazë në shkollë	63
Shtojca 4: Model për shënime përmbledhëse të një takimi për aktivitetet e zhvillimit profesional, të ekipit për ZHPBSH, grupi të kolegëve	65
Shtojca 5: Forma për reflektim për marrëdhënien tuaj të mentorimit	67

Shtojca 6: Udhëzuesi para vëzhgimit.....	68
Shtojca 7: Procesi i mentorimit – përmbledhje e diskutimit pas vëzhgimit	70
Shtojca 8: Forma të raportit përmbledhës nga trajnimet/ punëtoritë për ZHPBSH	72
Shtojca 9: Formë e raportit përmbledhës nga takimet mentoruese në nivel shkolle .	73
Shtojca 10: Formulari i monitorimit të brendshëm të ZHPMBSH	74
Shtojca 11: Programet/fushat e zhvillimit profesional sipas Kornizës Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve.....	76
Shtojca 12: Model i formularit për hartimin e programit të trajnimit nga shkolla për ZHPMBSH.....	79
Shtojca 13: Model i certifikatës për ZHPMBSH.....	81
Referencat & dokumente, doracak/udhëzues dhe burime të përdorura për këtë udhëzues dhe të dobishme për zhvillimin profesional me bazë në shkollë	84

Lista e shkurtesave

AP	Aktivat Profesionale
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
IA	Inspektorati i Arsimit
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KK	Këshillat e Klasës
KSZHM	Kornizë Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve
KSHLM	Këshilli Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PSAK	Plani Strategjik për Arsim në Kosovë
PZHI	Plani Zhvillimor Individual
PZHS	Plani i Zhvillimit të Shkollës
UA	Udhëzim Administrativ
VPM	Vlerësimi i Performancës së Mësimdhënësve
ZHP	Zhvillim Profesional
ZHPM	Zhvillim Profesional i Mësimdhënësve
ZHPBSH	Zhvillim Profesional me Bazë në Shkollë
ZHPV	Zhvillim Profesional i Vazhdueshëm

1. HYRJE

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë, në dekadën e fundit ka fituar një dimension të ri, në përpjekje për të ndërtuar një sistem të qëndrueshëm për zhvillimin e mësimdhënësve dhe për ta ndërlidhur atë me zbatimin e kurrikulës së re në Kosovë, gjegjësisht qasjen e bazuar në kompetenca. Ky proces kërkon një ndryshim të paradigmes nga të nxëniti me mësimdhënësin në qendër në të nxëniti me nxënësin në qendër, nga kontributi në rezultate, nga ajo që u dha, në atë që u arrit; nga "çfarë" në "pse dhe si".

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve (ZHPM) në Kosovë, është një komponentë e veçantë e Sistemit të Licencimit të Mësimdhënësve, i cili është vendosur si instrument i llogaridhënies, motivimit dhe si mekanizëm për zhvillim të vazhdueshëm profesional të të gjithë mësimdhënësve për mirëmbajtjen, përmirësimin dhe avancimin e kompetencave të mësimdhënies.

Në këtë drejtim, zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë është thelbësor. Ai fokusohet në problemet specifike të situatës që mësuesit hasin kur përpiqen të zbatojnë teknika të reja në praktikën e tyre të mësimdhënies në klasë dhe kryejnë detyrat e reja që dalin nga kurrikula e re, qasja e bazuar në kompetenca.

Ky udhëzues është hartuar me qëllim të mbështetjes së procesit të ZHPM me bazë në shkollë, dhe ka për qëllim të ofrojë udhëzime dhe orientime për shkollat rreth organizimit dhe realizimit të aktiviteteve të ZHPM me bazë në shkollë, por edhe për DKA-të dhe MASHTI-n për të ofruar mbështetjen e nevojshme për ZHPMBSH dhe sigurimin e cilësisë së aktiviteteve të ZHPM me bazë në shkollë.¹

¹ Udhëzuesi është përgatitur duke marrë për bazë dokumentet dhe udhëzuesit që rregullojnë ZHPM që njohin rëndësinë e ZHPM me bazë në shkollë dhe vendosin bazat për funksionimin e tij në nivel shkolle, duke përfshirë:

- Kornizën e Zhvillimit Profesional me Bazë në shkollë-Udhëzuesi për shkollat, drejtorët komunal të arsimit dhe Ministrinë e Arsimit (BEP/MASHT,2015,draft)
- Korniza Strategjike për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve (MASHT,2017)
- Korniza për Sigurimin e Cilësisë në Performancën e Shkollave (MASHT,2016)
- Udhëzuesin për shkollat, Drejtorinë Komunale të Arsimit dhe Ministrinë e Arsimit për Zhvillim Profesional me Bazë në Shkollë (ESIP/MASHT,2018,draft)
- Korniza implementuese me udhëzime për zhvillim profesional të mësimdhënësve (Planet/MASHT,2019,draft)

Ky udhëzues është një udhërrëfyes me ide për veprimet që duhet zbatuar në nivel shkolle, duke iu përshtatur kontekstit, rrethanave dhe mundësive të shkollës për të zbatuar ZHPBSH dhe do të shërbejë si një dokument bazë për të mbështetur procesin e ZHPM me bazë në shkollë, referuar UA-119/2020 për Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë, ku shkollat dhe mësimdhënësit do të jenë në gjendje të marrin një rol më proaktiv në proces të zbatimit përkatës të zhvillimit profesional, me mbështetje dhe përkrahje nga komunat/DKA-të dhe MASHTI.

Përkufizimi për zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë dhe parimet udhëheqëse

Çdo program dhe formë e zhvillimit profesional duhet të marrë parasysh se mësimi profesional nuk është "një ndërhyrje afatshkurtër, por... një proces afatgjatë që shtrihet nga arsimi i mësimdhënësve në universitet deri në trajnimin në punë në vendin e punës" (Richter et al, 2011). Andaj, mësimdhënësve u duhet dhënë kohë dhe mbështetje për të nxjerrë 'mësime' nga aktiviteti i ZHP, në mënyrë që të ketë ndryshim të vërtetë në klasë.

ZHPMBSH, përkufizohet si një proces në të cilin mësimdhënësit mësojnë nga njëri-tjetri, në mënyrë të përhershme në nivel shkolle, në përmirësimin e kompetencës së mësimdhënies, aftësive udhëheqëse për të përmirësuar dhe për të çuar përpara mësimin e nxënësve dhe performancën e shkollës.

Zhvillimi profesional me bazë në shkollë duhet të mbështetet në këto parime:

I thjeshtë – Një aspekt që fiton rëndësi gjatë zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë është thjeshtësia në komunikim, masa dhe veprimi. Procesi dhe të gjitha format e zhvillimit profesional organizohen në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, si për nga procedurat për përfshirje dhe kontribute në procesin e zhvillimit profesional, ashtu edhe për nga ana e praktikës dhe ndarjes së përvojave, mësimëve dhe nevojave për mbështetje.

Lehtësisht i realizueshëm – Gjatë zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë, kujdes i veçantë i kushtohet përkrahjes dhe identifikimit të mënyrave kreative

për mësim në vendin e punës, përzgjedhjes së programeve dhe formave për zhvillim profesional që janë të lehta të kuptohen dhe të praktikohen në nivel shkolle.

Joburokratik – Zhvillimin profesional të mësimeve me bazë në shkollë e karakterizon fleksibiliteti në procedura dhe hapat që janë të lejuar dhe të pranuar në funksion të zhvillimit profesional të mësimeve, dhe të ndryshimit të vërtetë në klasë, jo kufizimi burokratik i mundësive dhe shanseve të barabarta për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Bashkëpunues - Sipas parimit të bashkëpunimit aktivitetet profesionale dhe organet tjera profesionale duhet të bashkëpunojnë ngushtë në qartësimin e qëllimeve të ZHPMBSH, me rolin e tyre në këtë proces në identifikimin e nevojave për zhvillim profesional, të mundësive kohore e të kapaciteteve për realizimin e programeve dhe të aktiviteteve të ZHP, si dhe në përkrahjen e vazhdueshme për zbatimin e praktikave e përvojave të mira në punën me nxënës dhe me kolegë.

Efektiv – Zhvillimi i vazhdueshëm profesional duhet të rezultojë në përmirësimin e të nxënësve. Për të arritur këtë, gjatë zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet: sigurimit të cilësisë së procesit të zhvillimit profesional, zbatimit të mësimeve e përvojave të mira në praktikën e klasës, në të njëjtën kohë monitorimit dhe vlerësimit të efektivitetit të mësimeve.

I qëndrueshëm - Procesi i zhvillimit profesional të mësimeve siç është prezantuar në këtë udhëzues zhvillohet në atë mënyrë që të sigurojë zhvillim profesional të vazhdueshëm, zhvillim të kulturës për të mësuar së bashku edhe nga njëri-tjetri. Shkolla duhet të tregojë një fokus të veçantë në planifikimin e aktiviteteve dhe të buxhetit për zhvillim profesional, planifikimi duhet të jetë i bazuar në nevojat e mësimeve dhe përgatitje të duhura e praktika që sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Shkolla duhet të ndërtojë struktura funksionale të cilat e bëjnë të qëndrueshëm ZHPMBSH.

2. ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË, BAZUAR NË KORNIZËN LIGJORE DHE POLITIKAT ARSIMORE

2.1. Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë

Me Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar (KKAP), MASHTI është përcaktuar për një qasje të bazuar në kompetenca, respektivisht qasje të orientuar kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit (MASHT, 2016).

Që të sigurohet koherencë dhe konsistencë në procesin e zbatimit të kësaj qasjeje, KKAP vendos pesë parime themelore, të cilat janë referencë e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës, referencë e punës së shkollës edhe për ZHPMBSH:

Gjithëpërfshirja, i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. Shkolla e udhëhequr nga ky parim, mundëson qasje dhe përfshirje të barabartë të secilit nxënës duke kontribuuar në realizimin e plotë të potencialit individual të secilit fëmijë/të ri. *Ky parim duhet të udhëheqë qasjen e shkollës edhe ndaj zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë, në të gjitha fazat e procesit duke filluar nga analiza e nevojave, planifikimi, zbatimi, monitorimi dhe certifikimi si dhe duke ofruar mundësi të barabarta, pa asnjë përjashtim për të gjithë mësimeve.*

Zhvillimi i kompetencave, nënkupton arritjen e matshme të dijeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat shoqëria i konsideron të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Në sistemin e kurrikulës kompetencat kryesore zbërthehen nëpërmjet rezultateve të të nxënës, që duhet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit gjatë arsimit parauniversitar. *Ky parim duhet të udhëheqë edhe procesin e ZHPMBSH, në mënyrë të veçantë planifikimin dhe realizimin e ZHPMBSH, në mënyrë që ky proces t'i kontribuojë përkrahjes së nxënësve në zhvillimin dhe arritjen e kompetencave të përcaktuara me kurrikulë.*

Mësimdhënia dhe të nxënës e integruar, organizohet që të sigurohet të nxënës e plotë, i cili reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu, me dijen dhe informacionin që kemi për to. *Shkolla e udhëhequr nga ky parim në procesin e ZHPMBSH, duhet të mundësojë: Planifikimin dhe realizimin e*

aktiviteteve të trajnimit, mentorimin kolegjial dhe format e tjera të ZHPMBSH në kuadër të aktiveve profesionale drejt zhvillimit të kompetencave të mësimeve në përkrahje të nxënësve drejt zotërimit të rezultateve të të nxënësve të përcaktuara për fushën përkatëse kurrikulare.

Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkolle, i mundëson shkollës të ndërtojë profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor dhe infrastrukturës së saj dhe brenda kuadrit rregullator të vendosur nga MASHTI. *Kjo do të thotë se edhe ZHPMBSH duhet të ndërtohet mbi bazën e profilit të shkollës, autonomisë së shkollës dhe mundësive të barabarta.*

Përgjegjësia dhe llogaridhënia, nënkupton se procesi i decentralizimit të shërbimeve arsimore dhe rritja e autonomisë së shkollës, duhet të shoqërohen nga një mekanizëm funksional për përgjegjësi dhe llogaridhënie për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. *Ky parim, reflektohet edhe në punën e shkollës dhe rrjedhimisht edhe në procesin e ZHPMBSH, ndaj të cilit shkolla duhet të përgjigjet ndaj organeve të saj dhe ndaj sistemit, pastaj përmes këtij procesi të zhvillojë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm të ZHPMBSH.*

2.2. Korniza për Sigurimin e Cilësisë të Performancës së Shkollës

Dokumenti përcakton rolin e ri të shkollës dhe pritjet kryesore të shprehura me anë të kriterëve të cilësisë dhe treguesve të performancës për të gjitha shkollat e Republikës së Kosovës, në lidhje me pesë fusha të cilësisë së performancës së shkollës, respektivisht pesë shtylla të veprimtarisë së shkollës. Këto pesë fusha janë:

- 1.** Menaxhimi dhe qeverisja;
- 2.** Kultura dhe mjedisi;
- 3.** Mësimdhënia dhe nxënia;
- 4.** Zhvillimi profesional i mësimeve, dhe
- 5.** Performanca e nxënësve.

Secila fushë e cilësisë ka nga pesë kriterë. Këto kriterë burojnë nga pesë parimet e kurrikulës duke vënë në dukje ndikimin e secilit parim në secilën fushë të veprimtarisë së shkollës.

Kriteret e cilësisë së performancës së shkollës në fushën e zhvillimit profesional të mësimeve dhe disa përshkrime të kriterëve janë si në vijim:

Kriteri 1: Menaxhmenti i shkollës përfshin nxënësit, prindërit dhe mësimeve në planifikimin e ZHPM

- Personeli shkollor duhet të jetë në dijeni për qëllimet dhe prioritetet e shkollës për zhvillim profesional dhe ndërlidhjen e këtij procesi me përmirësimin e performancës së shkollës.
- Nevojat individuale të mësimeve duhet të identifikohen dhe të evidentohen nga vetë mësimeve, nga kolegët e tyre dhe përmes monitorimit të vazhdueshëm të punës së tyre nga udhëheqja e shkollës.
- Perceptimi i proceseve mësimore dhe performancës së mësimeve nga nxënësit dhe prindërit është një aspekt tjetër i rëndësishëm i vlerësimit të nevojave të mësimeve për ZHPM.

Kriteri 2: Praktikën e zhvillimit profesional të mësimeve janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve

- Rezultatet e arritshmërisë së nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore duhet të shfrytëzohen për planifikimin e ZHPM me bazë në shkollë.
- Monitorimi i ndikimit të ZHPM në ngritjen e cilësisë dhe të efektivitetit të mësimeve për zhvillimin e kompetencave kryesore

Kriteri 3: Praktikën e zhvillimit profesional të mësimeve janë në funksion të mësimeve të integruar

- ZHPM duhet t'i pasqyrojë mangësitë e evidentuara të performancës së mësimeve dhe organeve profesionale të shkollës në planifikimin dhe realizimin e mësimeve të integruar.
- Monitorimi i ndikimit të ZHPM në ngritjen e kapacitetit të mësimeve për planifikimin dhe realizimin e mësimeve të integruar.

Kriteri 4: Shkolla përdor në mënyrë efektive resurset e saj për aktivitetet e ZHPM

- Shkolla duhet të konsolidojë një praktikë të vetë-reflektimit të vazhdueshëm të mësimdhënësve mbi cilësinë e praktikave mësimore dhe të identifikimit të faktorëve që rrezikojnë cilësinë e mësimdhënies.
- Reflektimi kolegjial duhet të jetë pjesë e forumeve të ndryshme të mësimdhënësve, edhe në kuadër të organeve profesionale edhe përmes formave të tjera të ndërveprimit mes tyre.

Kriteri 5: Shkolla mbikëqyr ndikimin e ZHPM në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies

- Plani i shkollës për zhvillim profesional duhet të jetë në funksion të plotë të realizimit të politikave shtetërore arsimore dhe të misionit të shkollës.
- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve duhet të adresojë nevojat individuale të mësimdhënësve dhe nevojat e shkollës për avancim të praktikave të mësimdhënies dhe përmirësim të arritshmërisë së nxënësve.

2.3. Udhëzimi administrativ 04/2017 për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar²

Udhëzimi përcakton procedurat dhe rolin e institucioneve kryesore përgjegjëse për vlerësimin e performancës së shkollës, duke përfshirë vlerësimin e komponentit të ZHPM. Sipas këtij UA, shkollat duhet të bëjnë vetëvlerësimin e performancës në baza vjetore, ndërsa vlerësimi i jashtëm i shkollave, duhet të bëhet në baza pesëvjeçare nga Inspektorati i Arsimit.

2.4. Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë³

Korniza strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, përcakton standardet e mësimdhënësit, të cilat janë referenca kryesore për përgatitje të mësimdhënësve, përkrahje dhe zhvillimin profesional, vlerësim të performancës dhe për promovim të mësimdhënësve në karrierë. Standardet reflektojnë ndërveprimin në mes të fushave të

² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/4-2017-ua-vleresimin-e-performances-se-institucioneve-arsimore-ne-arsimin-parauniversitar-rotated.pdf>

³ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornize-strategjike.pdf>

mësimdhënies dhe treguesve të performancës. Fushat e përgjithshme për kompetencat/ standardet e mësimdhënësve, janë si në vijim:

- *Vlerat, qëndrimet dhe sjelljet profesionale,*
- *Njohuritë profesionale dhe të kuptuarit,*
- *Shkathtësitë dhe praktika profesionale,*
- *Mësimi dhe angazhimi profesional.*

Nivelet e ndryshme të zhvillimit profesional të mësimdhënësve janë të përfaqësuara në pesë faza të karrierës.

Korniza strategjike për ZHPM, rregullon zbatimin e sistemit të zhvillimit të mësimdhënësve në shërbim. Modalitetet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve, në aspektin e plotësimit të kërkesave për secilën fazë të karrierës dhe licencës (përfshirë rilicencimin ose promovimin) përfshijnë:

- Zhvillimin profesional nga ofruesit e jashtëm, duke përfshirë programet e trajnimit bazik dhe atij plotësues të ZHPM, të cilat iniciohen nga MASHTI, në përputhje me nevojat dhe fushat me prioritet kombëtar, dhe
- Zhvillimin profesional me bazë në shkollë (ZHPBSH), me qëllim që të adresojë nevojat e mësimdhënësve dhe nevojat praktike të mësimdhënësve të një shkolle, por të iniciuara nga vetë shkolla.

Referuar dokumentit të kornizës, zhvillimi profesional me bazë në shkollë është një proces ku mësimdhënësit mësojnë nga njëri - tjetri në mënyrë të vazhdueshme në nivel të shkollës, që t'i përmirësojnë shkathtësitë e tyre të mësimdhënies, besimet dhe aftësitë udhëheqëse për ngritjen dhe përmirësimin e të nxënësve të nxënësve.

Mësimdhënësit kanë nevojë për shkathtësi që të bashkëpunojnë dhe të mësojnë prej të tjerëve, për vlerësimin e praktikave të veta dhe të reflektojnë ndaj komenteve nga praktika e mësimdhënies, të shfrytëzojnë teknologjinë dhe rrjetet profesionale që ta përmirësojnë mësimdhënien dhe nxënien. Këtë e mundëson zhvillimi profesional me bazë në shkollë.

2.5. Udhëzimi administrativ 05/2017 për sistemin e licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë⁴

Udhëzimi rregullon dhe përcakton: (i) Sistemin e zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë; (ii) Kriteret dhe kushtet e licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në shtegun e karrierës; (iii) Akterët për zbatimin e sistemit të licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë; (iv) Detyrat dhe përgjegjësitë e akterëve kryesorë të përfshirë në këtë proces; dhe (v) Procedurat e aplikimit në sistemin e licencimit dhe procedurat për nxjerrjen e vendimit lidhur me aplikimet.

Për të siguruar koherencën dhe konsistencën e procesit të ZHPM, ky proces, është integruar brenda sistemit të licencimit, i cili është vendosur si:

- Instrument i llogaridhënies;
- Instrument i motivimit - lidhjes së nivelit të performancës me paga të mësimdhënësve;
- Mekanizëm për zhvillim të vazhdueshëm profesional - ndërtimi i një sistemi të qëndrueshëm të ZHPM.

Ndërlidhja e ZHPM me sistemin e licencimit, përkatësisht me kriteret e ZHPM për licencim dhe ruajtje sipas llojeve të licencës prezantohet në tabelën vijuese.

Nr .	Llojet e licencës	Kriteret e ZHP për lëshimin e licencës	Kriteret E ZHP për ruajtjen e licencës
1	Mësimdhënës i karrierës	▪ Licenca e parë për mësimdhënës të karrierës u lëshohet mësimdhënësve të kualifikuar sipas normativit në fuqi për mësimdhënës në nivelin përkatës të arsimit, që	▪ Licenca e mësimdhënësit të karrierës është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit pozitiv të performancës, sipas UA për VPM (kriteret për licencën Mësimdhënës i karrierës) dhe plotësimit të së paku 100 orëve të reja të trajnimit në programet e trajnimit për licencë

⁴ <https://masht.rks.gov.net/uploads/2017/08/sistemimi-i-licencimit-dhe-zhvillimit-te-mesimdhenesve-ne-karriere.pdf>

		kanë plotësuar një vit përvojë pune.	të karrierës.
2	Mësimdhënës i avancuar	Ka përfunduar së paku 300 orë trajnim, prej të cilave 100 orë trajnim në programet e trajnimit për licencë të mësimdhënësit të avancuar	Licenca e mësimdhënësit të avancuar është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit pozitiv të performancës, sipas UA për VPM (kriteret për licencën Mësimdhënës i avancuar) dhe plotësimit të së paku 200 orëve të reja të trajnimit në programet e trajnimit për licencë të avancuar.
3	Mësimdhënës mentor	Ka përfunduar së paku 200 orë trajnim pas marrjes së licencës së mësimdhënësit të avancuar, prej tyre së paku 100 orë trajnim duhet të jenë nga fusha e mentorimit të mësimdhënësve	Licenca e mësimdhënësit mentor është valide për 5 vite dhe ripërtërihet pas vlerësimit pozitiv të performancës, sipas UA për VPM (kriteret për licencën Mësimdhënës mentor) dhe plotësimit të së paku 200 orëve të reja të trajnimit.
4	Mësimdhënës i merituar	- Posedon licencë të mësimdhënësit mentor për një periudhë prej së paku 10 vitesh; - Ka përfunduar së paku 450 orë trajnim pas marrjes së licencës së parë për mësimdhënës mentor, sipas përcaktimeve në Kornizën strategjike për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë - Licenca e mësimdhënësit të merituar është e përhershme.	

Sipas UA nr. 05/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë, neni 8, paragrafi 4, nga viti 2021, zhvillimi profesional i mësimdhënësve do të bëhet 50% me ofrimin e programeve nga ofertuesit e jashtëm dhe 50% përmes qasjes me bazë në shkollë.

Prandaj, shkolla duhet të niset nga roli i përcaktuar për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve, duhet të trajtojë në mënyrë tërësore ZHPM duke pasur parasysh relacionin me sistemin e licencimit të mësimitdhënësve dhe kërkesat për përmirësimin dhe avancimin e praktikave të mësimitdhënies në punën e përditshme me nxënës.

2.6. Udhëzimi administrativ nr. 14/2018 mbi Vlerësimin e Performancës së Mësimitdhënësve⁵

Udhëzimi zbaton kornizën e përgjithshme të kompetencave të mësimitdhënësve dhe standardeve përkatëse të përcaktuara me Kornizën Strategjike për Zhvillimin e Mësimitdhënësve në Kosovë (MASHT, 2017) dhe përshkruan sistemin e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve, i përbërë nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm.

Referuar këtij udhëzimi, prezantimi nga shkolla dhe mësimitdhënësi individual për përmbushjen e kërkesave të përcaktuara për zhvillim profesional sipas sistemit të licencimit, mund të jetë pikënisje për fillimin e vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve individualë, në mënyrë të veçantë për përtëritje dhe avancim në sistemin e karrierës së mësimitdhënësve.

Prandaj, shkolla dhe secili mësimitdhënës në mënyrë individuale duhet të tregojë përkushtim në përmbushjen e kërkesave për zhvillim profesional në relacion me përmbushjen e rolit për mbështetje cilësore të të nxënësve dhe me përmbushjen e kërkesave për sistemin e licencimit të mësimitdhënësve.

Të gjitha iniciativat e shkollës që planifikohen dhe realizohen në nivel shkolle për ZHPM duhet të jenë në funksion të zhvillimit të kompetencave të mësimitdhënësve që të përmirësohen shkathtësitë e tyre të mësimitdhënies me qëllim të ngritjen dhe përmirësimin e të nxënësve dhe në funksion të plotësimit të kërkesave të ZHP për sistemin e licencimit.

⁵ <https://masht.rks-gov.net/udhezimet-administrative-2018>

2.7. Udhëzimi administrativ nr. 06/2017 për kriteret dhe procedurat e aprovimit të programeve për zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë⁶

Udhëzimi ndërlidhet me dokumentin Korniza Strategjike për Zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë dhe me UA për licencimin e mësimdhënësve. Udhëzimi përcakton:

- Detyrat dhe përgjegjësitë e MASHTI-t në fushën e zhvillimit profesional;
- Kriteret dhe procedurat e aprovimit të institucioneve (ofertuesve) dhe programeve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe punonjësve arsimorë;
- Pozitën e programeve paraprake të aprovuara nga MASHT/KSHLM;
- Autorësinë dhe të drejtën e ofrimit të programeve të aprovuara;
- Sigurimin e cilësisë së trajnimeve.

Referuar këtij udhëzimi, shkolla në ZHPMBSH merr për bazë:

- **Orët/kohën e trajnimit të drejtpërdrejtë, kur trajneri në nivel shkolle zhvillon seanca trajnuese me pjesëmarrësit në trajnim;**
- **katalogun e programeve të trajnimit; dhe**
- **kërkesat që duhet të plotësojë shkolla nëse synon të bëhet ofruese e jashtme e trajnimeve për shkollat tjera.**

2.8. Udhëzimi administrativ nr. 119/2020 mbi Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë

Për qëllime praktike, procesi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë, është ndarë në procedurat e brendshme (shkollore) dhe të jashtme (mbështetëse). Kjo ndarje pasqyron një situatë në të cilën një shkollë planifikon, zbaton dhe vërteton zhvillimin profesional të shkollës, ndërsa institucionet dhe autoritetet e tjera të arsimit përgjegjës (DKA, MASHTI, IPK, IA) sigurojnë monitorim dhe mbështetje për këtë proces. Në këtë

⁶ <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/6-2017-ua-per-kriteret-dhe-procedurat-e-aprovimit-te-programeve-per-zhvillim-profesional-te-mesimdhenesve-dhe-punonjesve-arsimor-rotated.pdf>

skemë, DKA përfaqëson ndërlidhjen mes shkollave dhe autoriteteve të arsimit të nivelit qendror, nëpërmjet funksioneve të saj si fasilituese, garantuese e cilësisë dhe vërtetuese e të gjithë procesit.

Sipas UA mbi ZHPMBSH zbatohet në tërë sektorin e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës. Gjithashtu, UA përcakton:

- Format e zhvillimi profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Programet e trajnimit dhe të aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Njohjen e orëve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Procedurat e brendshme të zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Procedurat e jashtme që rregullojnë dhe mbështesin zhvillimin profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë;
- Procedurat dhe kriteret e certifikimit të ZHPMBSH;
- Rolin dhe përgjegjësitë e akterëve;
- Strukturat mbështetëse për ZHPMBSH, si dhe
- Financimin e ZHPMBSH.

Detajet sqarohen në kapitujt vijues të këtij udhëzuesi.

Sa i përket UA mbi Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve me Bazë në Shkollë, udhëheqja e shkollës dhe bartësit e procesit të ZHPMBSH duhet të sigurohen që:

çdo veprim i planifikuar në kuadër të shkollës për ZHPMBSH, të përcaktohet duke iu referuar këtij UA.

3. FORMAT E ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË

Zhvillimi profesional me bazë në shkollë, (ZHPBSH) përfshin aktivitetet e zhvillimit profesional në shkollë në përputhje me dispozitat ligjore dhe procedurat e miratuara, nën drejtimin e drejtorit të shkollës dhe Këshillit drejtues të shkollës dhe me pjesëmarrjen aktive të stafit të shkollës dhe të të gjitha strukturave shkollore. Zhvillimi profesional me bazë në shkollë, mund të jetë i veçantë për çdo shkollë, prandaj duhet të miratohet në përputhje me parimet dhe procedurat e përcaktuara për ZHPMBSH.

Procesi i ZHPMBSH fillon me njohjen dhe të kuptuarit e përbashkët në nivel shkolle për format dhe mundësitë e ZHPMBSH. Sipas UA që rregullon ZHPMBSH, format e ZHPMBSH janë si në vijim:

- Trajtime në nivel shkolle sipas programit të përzgjedhur nga shkolla, në përputhje me procedurat e brendshme dhe të jashtme;
- Punëtori dhe seminare;
- Mentorim nga trajnerë dhe mentorë të certifikuar;
- Këshillim dhe mentorim ndërmjet kolegëve;
- Kërkim/Hulumtim në veprim;
- Javë të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Pjesëmarrje në seminare, rrjete profesionale, konferenca, vizita studimore të ndërlidhura me planin individual për ZHPM dhe planin vjetor të shkollës për ZHPM.

Është detyrë e secilës shkollës që të analizojë mundësitë për shfrytëzimin e këtyre formave që njihen me ZHPMBSH dhe të përcaktohet fillimisht në disa forma për të cilat shkolla ka kapacitete dhe mundësi që t'i realizojë me procedura të brendshme.

Format e ZHPMBSH lidhen me orët e ZHP të cilat njihen në sistemin e licencimit të mësimdhënësve. Për të qartësuar këtë proces në komunitetin e mësimdhënësve, drejtuesit e shkollës me kohë duhet të informojnë mësimdhënësit se:

- Nga viti 2021, 50% e orëve të grumbulluara nga ZHPMBSH mbulojnë kërkesat e zhvillimit profesional në sistemin e licencimit të mësimeve për secilin lloj të licencës.
- Orët e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë llogariten në varësi të programit të trajnimit të aprovuar/miratur dhe të zbatimit të tij në nivel shkolle apo varësisht nga aktiviteti profesional i miratur me bazë në shkollë.
- Një ditë e plotë trajnimi, punëtorie apo seminari me tema profesionale përbëhet nga 6 orë.
- Në raste të caktuara, shkolla mund t'i planifikojë dhe t'i realizojë programet e trajnimit, punëtoritë, seminarët dhe temat profesionale, në disa seanca ditore me nga 3 orë, të cilat pastaj mund t'i përmbledhë në një certifikatë të vetme në përfundim të programit apo aktivitetit përkatës të zhvillimit profesional.
- Një orë e mentorimit të mësimit nga trajneri dhe mentori i certifikuar përbëhet nga 45 minuta, sa një orë mësimore standarde.
- Numri i orëve të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, për detyra praktike profesionale, kërkim/hulumtim në veprim, mentorim kolegjial, etj., njihet në ZHPMBSH sipas numrit të orëve që ka programi, aktivitetit përkatës të zhvillimit profesional, miratimit paraprak nga organi përkatës i shkollës me arsyeshmëri përkatëse dhe dëshmi të realizimit.
- Orët e pjesëmarrjes në seminare, në rrjete profesionale, konferenca jashtë shkollës, vizita studimore, të realizuara në ndërlidhje me planin individual për ZHPM dhe planin vjetor të shkollës për ZHPM, njihen nga shkolla në bazë të dëshmive nga certifikata e pjesëmarrjes dhe dëshmive tjera relevante që prezantohen.

4. PROGRAMET E TRAJNIMIT DHE AKTIVITETET E ZHPMBSH

Nisur nga fakti se zhvillimi profesional me bazë në shkollë mund të jetë i veçantë për çdo shkollë, është e nënkuptueshme që programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPMBSH, mund të dallojnë nga shkolla në shkollë dhe njëkohësisht mund të jenë të

njëjta ose të përafërta, në varësi nga nevojat dhe specifikat e shkollave dhe të mësimdhënësve.

Referuar udhëzimit administrativ përkatës, ZHPMBSH realizohet me programe të trajnimit dhe aktivitete të ndryshme të ZHPM, duke përfshirë:

- Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM të zhvilluara nga vetë shkolla për nevojat e brendshme të ZHPMBSH.
- Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM të zhvilluara nga ekipe profesionale të mësimdhënësve me mbështetje nga komunat/DKA për nevojat e ZHPMBSH.
- Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM të zhvilluara nga MASHTI për nevojat e ZHPMBSH.
- Programet e trajnimit të zhvilluara nga ofruesit e jashtëm, të aprovuara dhe të lejuara nga MASHTI/KSHLM për përdorim nga shkollat për nevojat e ZHPMBSH.

Programet e trajnimit të zhvilluara nga shkolla për nevojat e brendshme nuk ka nevojë të kalojnë në procedura të miratimit nga MASHTI, për faktin se ato janë tipike të brendshme dhe konsiderohet se janë të lidhura drejtpërdrejt me praktikën e mësimdhënies dhe me punën me nxënës në klasë. Ato kalojnë në procedura të miratimit nga MASHTI, në rastet kur shkolla synon të bëhet ofrues i jashtëm i programeve të trajnimit për shkollat tjera në nivel komune dhe me gjerë.

Parakushtet elementare për të ofruar programe të trajnimit dhe aktivitete të ZHPMBSH që kërkohen nga një shkollë janë përkushtimi, angazhimi dhe kapacitetet me:

- Trajnerë dhe mentorë të certifikuar në programe të ndryshme trajnuese.
- Mësimdhënës me studime Master në programet që lidhen me gjithëpërfshirjen, kurrikulat, mësimdhënien, udhëheqjen arsimore.
- Mësimdhënës me specializime të veçanta në fushat që lidhen me nevojat për ZHPM.
- Mësimdhënës me performancë të lartë në praktikën e mësimdhënies.
- Mësimdhënës të përkushtuar ndaj ndryshimeve në arsim.

Me këto përcaktime, theksohet qartë se shkolla me kapacitetet e saj mund të zhvillojë vetë programe të trajnimit për nevojat e mësimdhënësve të saj dhe njëkohësisht mund të marrë programe të gatshme të zhvilluara nga DKA dhe MASHTI, apo të lejuara nga MASHTI për nevojat e ZHPMBSH. Shkolla duhet të reflektojë me kohë ndaj kërkesave

të UA për ZHPMBSH se si t'i qaset programeve të trajnimit në bazë të nevojave të mësimdhënësve dhe mundësive e kapaciteteve të brendshme për t'i realizuar në nivel shkolle.

Pra, është detyrë e secilës shkollës që me kohë:

- (i) të analizojë përcaktimet ligjore për modalitetet e shfrytëzimit dhe të zhvillimit të programeve të trajnimit dhe të aktiviteteve tjera të ZHPM;**
- (ii) të analizojë nevojat e mësimdhënësve të shkollës për ZHP; dhe**
- (iii) të analizojë mundësitë e shfrytëzimit të programeve ekzistuese që lidhen me nevojat e mësimdhënësve.**

Pastaj, të shohë mundësitë e zhvillimit të tyre me kapacitetet e brendshme për kërkesat/nevojat për të cilat nuk ka programe specifike. Po ashtu, rrjeti i shkollave bashkëpunuese, por edhe mbështetja nga DKA dhe MASHTI mund të jenë ndihmesë e madhe.

Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM që zhvillohen dhe realizohen me bazë në shkollë, duhet të ndërlidhen me mësimdhënien dhe aspektet e ndërlidhura me procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, duhet të jenë në funksion të mundësive që mësimdhënësit të mësojnë nga njëri-tjetri në përmirësimin e kompetencës së mësimdhënies, të aftësive udhëheqëse që ta përmirësojnë dhe ta çojnë përpara mësimin e nxënësve dhe performancën e shkollës. Programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM me bazë në shkollë, miratohen në nivel shkolle nga KDSH me propozim të drejtorit të shkollës ose kryetarit të aktivitetit profesional.

Programet e trajnimit të zhvilluara nga shkolla për nevojat e brendshme duhet të hartohen mbi disa pika referimi si:

- *Detajet e zhvillimit të programit të trajnimit, ku i referohen procesit të zhvillimit të programit, analizave të nevojave të bëra, këshillimeve profesionale në nivel të aktiveve profesionale, etj.;*
- *Rezultatet që priten nga programi i trajnimit;*
- *Përmbajtja e programit dhe aktivitetet që sigurojnë arritjen e rezultateve të programit;*

- *Materialet e trajnimit;*
- *Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues.*

Gjithashtu, programet e trajnimit të zhvilluara nga shkolla për nevojat e brendshme duhet të përmbajnë edhe aspekte të përgjithshme, si trajnerët të cilët ofrojnë programin, grupi i mësimdhënësve të synuar për përfshirje në programin e trajnimit, numri i orëve të trajnimit, të mentorimit, të detyrave praktike, si dhe kriteret për certifikim etj.

5. PROCEDURAT E BRENDSHME TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË

Procesi i ZHPMBSH duhet të zhvillohet sipas procedurave të brendshme të ZHPMBSH, të cilat janë përvijuar në Udhëzimin administrativ që rregullon ZHPMBSH. Respektimi i procedurave të brendshme të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë, bëjnë të mundur që procesi të jetë gjithëpërfshirës, i barabartë dhe mundësues për të gjithë mësimitdhënësit, praktik dhe i lehtë që të zbatohet në nivel shkolle. Respektimi i procedurave të brendshme e bën shkollën funksionale dhe e mban brenda rolit të saj thelbësor për përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së mësimitdhënies dhe rezultateve të nxënësve.

Pjesë përbërëse e procedurave të brendshme të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve me bazë në shkollë, janë aspektet si në vijim:

- Informimi dhe sensibilizimi i mësimitdhënësve dhe i organeve të shkollës për mundësitë dhe kërkesat e zhvillimit profesional me bazë në shkollë;
- Analiza e kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në nivel shkolle;
- Mbledhja e të dhënave – identifikimi dhe vlerësimi i nevojave për ZHPM;
- Përcaktimi i prioriteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë;
- Planifikimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë;
- Zbatimi i programeve të trajnimit dhe aktiviteteve të ZHP me bazë në shkollë;
- Monitorimi i brendshëm i aktiviteteve të ZHPBSH, dhe
- Raportimi i aktiviteteve të ZHPBSH.

5.1. Informimi dhe sensibilizimi i mësimitdhënësve për mundësitë dhe kërkesat e zhvillimit profesional

Që të sigurohet të kuptuarit e përbashkët për ZHPM në komunitetin e shkollës dhe për përfshirjen e të gjithë mësimitdhënësve në aktivitetet e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që fillimisht të gjithë mësimitdhënësit dhe organet e shkollës:

- të jenë të njoftuar me mundësitë dhe kërkesat e zhvillimit profesional, me fokus ZHPM me bazë në shkollë, procedurat e brendshme dhe procedurat e jashtme;
- t'i kenë të qarta implikimet e zhvillimit profesional me bazë në shkollë në sistemin e licencimit të mësimeve;
- të jenë të vetëdijshëm për pjesën e vet të përgjegjësisë në përmbushjen e kërkesave për zhvillim profesional;
- të jenë të njoftuar me aktivitetet përgatitore për identifikimin e nevojave për ZHP, planin e zhvillimit profesional dhe format e pjesëmarrjes së tyre në këtë proces.

Çështjet kryesore që duhet të jenë në fokus të informimit të mësimeve përfshijnë:

- Rolin e ri të shkollës në fushën e zhvillimit profesional të mësimeve;
- Profilin e kompetencave/standardet e mësimeve për faza të ndryshme të karrierës të zëritë në dokumentin Korniza për zhvillimin e mësimeve në Kosovë;
- Llojet e licencës, kriteret e ZHP për lëshimin e licencës dhe për kriteret e ZHP për ruajtjen e licencës;
- Dallimet kryesore ndërmjet ZHP me programe nga ofertuesit e jashtëm dhe ZHP përmes qasjes zhvillimore me bazë në shkollë;
- Format e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë;
- Programet dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë;
- Orët e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë;
- Identifikimin e nevojave për ZHPMBSH;
- Hapat kryesorë për realizimin e ZHPMBSH;
- Planifikimin dhe realizimin e proceseve për zhvillim profesional me bazë në shkollë;
- Prioritetet e shkollës gjatë fazës përgatitore për zbatim, etj.

5.2. Analiza e kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në nivel shkolle

Ky është hapi i parë që duhet të ndërmerret nga shkolla, menjëherë pas informimit të mësimitdhënësve dhe organeve të shkollës me kërkesat e reja të zhvillimit profesional dhe implikimet e ZHPM në sistemin e licencimit të mësimitdhënësve.

Procesi i realizimit të kësaj analize duhet të jetë gjithëpërfshirës në mënyrë që gjithë mësimitdhënësit të kenë një qëndrim të përbashkët sa i përket situatës me përfshirjen e tyre në ZHP, nevojat e tyre dhe mundësitë e kontributit të tyre në këtë proces.

Kjo analizë duhet të fokusohet në:

- Kriteret e cilësisë në fushën e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve dhe treguesit e performancës së këtyre kriterëve;
- Planin e zhvillimit të shkollës;
- Përfshirjen e mësimitdhënësve në programe të trajnimit dhe forma të tjera të zhvillimit profesional;
- Mësimet nga ZHP dhe përvojat e zbatimit në praktikën e klasës;
- Problemet kryesore me të cilat përballen mësimitdhënësit;
- Përdorimin e resurseve të shkollës për ZHP, etj.

Për këtë qëllim, drejtori i shkollës angazhohet me koordinatorin për sigurimin e cilësisë (KC), ose delegon përgjegjësinë që këtë analizë ta bëjë KC, zëvendësdrejtori, pedagogu i shkollës ose ekipi për zhvillimin e shkollës.

5.3. Mbledhja e të dhënave - identifikimi dhe vlerësimi i nevojave

Pas analizës së kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në nivel shkolle, fillohet me mbledhjen e të dhënave, identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional të mësimitdhënësve.

Vlerësimi i nevojave individuale të mësimitdhënësve duhet të bazohet në kompetencat për mësimitdhënës të përcaktuara në Kornizën Strategjike për Zhvillimin Profesional të Mësimitdhënësve (MASHT, 2017), kriteret dhe treguesit e përcaktuar për Komponentin e Mësimitdhënies dhe të mësuarit në Kuadrin për Sigurimin e Cilësisë në Performancën e Shkollës (MASHT, 2016) dhe në planin vjetor të zhvillimit profesional të secilit mësimitdhënës. Për këtë qëllim, një formë e identifikimit dhe vlerësimit të nevojave për

ZHPM duhet të vihet në dispozicion të shkollave (ose të dizajnohen nga vetë shkolla) për përdorim në baza vjetore, e cila është e natyrës formative. Vlerësimi i nevojave individuale është i një rëndësie të veçantë dhe duhet të jetë sa më i saktë që është e mundur, sepse gjithashtu informon procesin e analizës së nevojave në nivel shkolle të ndërlidhura me planin e shkollës për ZHPM, por më tutje informon analizën e nevojave në nivel komunal dhe planin komunal për ZHPM.

Gjatë vlerësimit individual të mësimeve, mësuesi dhe drejtori i shkollës duhet gjithashtu të marrin parasysh pikëpamjet dhe perceptimet e nxënësve dhe prindërve (ecurinë e nxënësve gjatë orëve të mësimi, nivelin e mirëkuptimit, angazhimit, kërkesat, ankesat, etj.) si dhe performancën e nxënësve në fund të çdo periudhe mësimore, dhe në fund të vitit shkollor. Duhet të merren në konsideratë edhe reagimet nga këshillat e nxënësve dhe prindërve në lidhje me performancën specifike të mësimeve individuale (qoftë shqetësimi specifik ose njohja e punës).

Vlerësimi i nevojës në nivel shkolle, përgatitet në bazë të planeve zhvillimore individuale të mësimeve, ku edukatorët, mësuesit dhe mësuesit lëndorë, artikulojnë nevojat e tyre profesionale për të mësuar (shih detajet mbi procedurat e planifikimit). Këto plane synojnë të udhëheqin aktivitetet e veçanta të mësimeve të ZHP, por gjithashtu ofrojnë të dhëna cilësore për të përcaktuar nevojat e përgjithshme për ZHPM në shkollën përkatëse. Në të njëjtën kohë, ato tregojnë potencialin aktual të shkollës (burimet ekzistuese njerëzore) për mentorimin dhe aktivitetet e tjera të ZHPM.

Ekzistojnë disa procedura standarde të identifikimit dhe vlerësimit të nevojave, dhe forma më standarde është konsultimi me vetë mësuesin. Konsultimi mund të ndodhë në disa forma:

- Personi i caktuar nga KDSH (drejtori, koordinatori për sigurimin e cilësisë, zëvendësdrejtori ose pedagogu i shkollës) viziton disa mësime në orë mësimore për të vëzhguar praktikën e tyre si dhe për të identifikuar vështirësitë në mësimdhënie nga këndvështrimi i vëzhguesit. Në rastet e tilla zakonisht zhvillohet një bisedë me mësuesin para dhe pas vëzhgimit të orës mësimore për të identifikuar anët pozitive, por edhe vështirësitë dhe nevojat për zhvillim profesional.

- Intervistat me mësimdhënës ku mësimdhënësit theksojnë parapëlqimet e tyre për zhvillim profesional apo për programe të caktuara. Intervistat mund të bëhen edhe në formë të grupeve të fokusit me mësimdhënës të shkollës, kryetarë të aktiveve profesionale, për të mësuar perceptimet kolektive rreth nevojave për zhvillim profesional.
- Pyetësorët me një mostër të mësimdhënësve apo me tërë personelin e shkollës për identifikimin e nevojave të stafit mësimor për ZHP.
- Shqyrtimi i Planeve Individuale për zhvillim profesional ku mësimdhënësit artikulojnë nevojat e tyre për zhvillim dhe mësim profesional. Këto plane mund të japin të dhëna cilësore për caktimin e nevojave të përgjithshme e të veçanta të mësimdhënësve të shkollës përkatëse.
- Analiza e raportit të vetëvlerësimit të shkollës dhe raportit të vlerësimit të jashtëm nga Inspektorati i Arsimit, diskutimeve në kuadër të aktivitetit profesional, raporteve të vëzhgimit në orë mësimore, raporteve të vlerësimit të performancës së mësimdhënësve, vetëvlerësimit, reflektimit mbi praktikën e mësimdhënies në shkollë dhe formave tjera relevante.

Në vëmendje:

Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave nga shkolla për ZHPMBSH bëhet çdo vit, gjatë periudhës janar – prill, në mënyrë që gjatë periudhës maj – korrik të vitit përkatës të finalizohet plani vjetor për ZHPMBSH për vitin shkollor vijues.

Gjatë kësaj periudhe secili mësimdhënës por edhe përfaqësuesit tjerë të shkollës, drejtori, zëvendësdrejtori, pedagogu, psikologu, etj., në mënyrë individuale bëjnë vetë reflektime dhe vetëvlerësime për nevojat personale për ZHP dhe hartojnë planet individuale për ZHPM.

Planet individuale për ZHP, së bashku me raportet nga analizat tjera përdoren si një bazë për përcaktimin e nevojave dhe fushave me prioritet për ZHPMBSH.

Krahas nevojave të artikuluar të mësimdhënësve, për vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional zakonisht merren parasysh edhe një numër faktorësh. Disa nga këta faktorë janë:

- Prioritetet e shkollës (të theksuara në Planin Zhvillimor të Shkollës);
- Prioritetet komunale në zhvillimin e arsimit në Komunë dhe në fushën e zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Prioritetet e identifikuara shtetërore (si reformimi i kurrikulës shkollore, integrimi i teknologjisë në arsim, arsimit gjithëpërfshirës, etj);
- Resurset që ka shkolla në dispozicion qoftë si mjete vetjake, qoftë në formë të projekteve me të cilat ka bashkëpunim;
- Zhvillimet moderne në shkencën e edukimit, gjegjësisht avancimi i njohurive për mësimdhënie moderne në kontekst të literaturës vendore apo ndërkombëtare.

5.4. Përcaktimi i prioriteteve për zhvillim profesional me bazë në shkollë

Mbi bazën e analizës së kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle, analizës dhe vlerësimit të nevojave të mësimdhënësve për zhvillim profesional dhe mbi bazën e raportit, shkolla përcakton prioritetet për zhvillim profesional të mësimdhënësve të saj.

Me rastin e përcaktimit të prioriteteve të ZHP, shkolla përcakton detyrimin që merr që të përkrahë zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Prioritetet e shkollës për zhvillim profesional të mësimdhënësve, duhet të përmbajnë së paku tre nga komponentët vijues:

- Përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore dhe në realizimin e potencialit të tyre;
- Adresimin e problemeve kryesore me të cilat përballen mësimdhënësit në punën e tyre profesionale;
- Avancimin e njohurive të praktikës për mësimdhënie në kontekstin e kurrikulës së re dhe të praktikave të mira në nivel shkolle dhe të programeve e literaturës vendore apo ndërkombëtare.

Në vëmendje: me propozim të drejtorit të shkollës, prioritetet e ZHPMBSH miratohen nga KDSH dhe integrohen në planin zhvillimor të shkollës.

5.5. Planifikimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë

Institucionet shkollore duhet të jenë në hap me arritjet më të reja në fushën e dijes, shkencës e teknologjisë për avancimin e përvojave të nxënies (si në kuptimin e përmbajtjes, ashtu dhe në metodologjinë e zhvillimit të të nxënit). Shkolla njëkohësisht duhet të sigurojë që mësimdhënësit të përcjellin edhe trendët e shkencës së pedagogjisë, të psikologjisë, të shkencave sociale e të tjera, por edhe të reflektojnë vazhdimisht për efektivitetin e performancës së tyre në raport me arritjen e pritshmërive të përcaktuara me kurrikulat bërthamë dhe në raport me performancën e nxënësve (MASHT, 2016).

Prandaj,

zhvillimi profesional i mësimdhënësve duhet të planifikohet me kujdes dhe të reflektojë nevojat individuale të mësimdhënësve dhe nevojat e shkollës për avancim të praktikave të mësimdhënies dhe përmirësim të arritshmërisë së nxënësve. Plani i shkollës për zhvillim profesional duhet të jetë në funksion të plotë të realizimit të politikave shtetërore arsimore dhe specifiku të misionit të shkollës.

Pas analizës së kontekstit të përgjithshëm të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel shkolle, identifikimit të nevojave dhe pas caktimit të prioritetëve të zhvillimit profesional e përcaktimit të prioritetëve për zhvillim profesional me bazë në shkollë, bëhet planifikimi i aktiviteteve të nevojshme për planin afatshkurtër dhe/apo afatmesëm. Planifikimi për implementimin/zbatimin e ZHPBSH përfshin:

- Arsyeshmërinë dhe qëllimet e gjithmbarshme të planit;
- Prioritetet për ZHP dhe objektivat e zërthyera sipas prioritetëve;
- Aktivitetet kryesore sipas prioritetëve dhe afatit kohor;
- Modalitetet dhe format se si do të realizohen programet e trajnimit dhe aktivitetet e zhvillimit profesional;
- Planin dinamik dhe afatet kohore;
- Përgjegjësitë sipas prioritetëve dhe aktiviteteve gjegjëse;
- Resurset materiale dhe njerëzore që nevojiten për realizim të aktiviteteve;
- Koston financiare që vjen nga këto aktivitete;

- Treguesit e realizimit të prioriteteve të ZHPBSH.

Krahas planit të shkollës për ZHPMBSH, secili mësimmshënës kujdeset për planin personal për zhvillim profesional, realizimin e aktiviteteve me prioritete, të tij/saj, të cilat nuk janë integruar në planin e shkollës, por që janë të nevojshme për plotësimin e nevojave për zhvillim profesional të vetë mësimmshënësit dhe që dëshmojnë në portfolion e mësimmshënësit.

5.6. Zbatimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë

Zhvillimi profesional i mësimmshënësve me bazë në shkollë, fillimisht duhet të absorbojë të gjitha mundësitë që janë në dispozicion brenda shkollës (mentorimi kolegial, format e ndryshme të shkëmbimit të përvojave të mira dhe ekspertizës ndërmjet mësimmshënësve, zhvillimi profesional nga ekipet profesionale të shkollës) për të vazhduar pastaj me format tjera jashtë shkollës, përfshirë: shkëmbimin e përvojave me shkollat tjera dhe organizimin e programeve të zhvillimit profesional në bashkëpunim me ofertues të këtyre shërbimeve (MASHT, 2016).

Është e rëndësishme të mos harrohet se jo çdo ZHP është njësoj. Kur planifikohen disa aktivitete, duhet bërë kujdes që të dallohet mes zhvillimit profesional, formal dhe informal. Zhvillimi profesional formal mund të strukturohet dhe të matet, prandaj është i obligueshëm. Për shembull, mësimmshënësit duhet të plotësojnë 20-30 orë ZHP në vit. Nga ana tjetër, zhvillimi profesional informal zakonisht është i nxitur nga mësimmshënësit. Është individual dhe bashkëpunues, dhe mund të inkurajohet dhe lehtësohet, nuk mund të ndalohe (Goddard, T. & Buleshkaj, O., 2018).

Lehtësuesit/trajnerët, luajnë një rol të veçantë në zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë. Sipas Goddard, T. & Buleshkaj, O. (2018), lehtësuesi është personi që drejton aktivitetin e mirëfilltë të ZHP-së.

Struktura e një aktiviteti të ZHP-së bazohet në disa elemente të ndryshme. Joyce dhe Showers (2002) i kanë cilësuar si katër komponentët e trajnimit, të përbërë nga: teoria (njohuri për diçka, zhvillimi i një shkathtësie); demonstrimi (modelimi i shkathtësive - Lehtësuesi tregon si bëhet diçka); praktika (mësimmshënësi praktikon shkathtësitë në klasën e tij/saj, zakonisht për një periudhë të rekomanduar prej 8-10 javësh); dhe, latimi-ushtrime stërvitje (coaching) mes kolegëve (mësimmshënësi angazhohet në punën e vazhdueshme bashkëpunuese me kolegët për të planifikuar dhe zhvilluar orët e mësimit dhe materialet e nevojshme për të zbatuar trajnimin në mënyrë efektive).

Rol të veçantë në zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë luan edhe mësimehmënesi mentor, roli i të cilit është të ofrojë mbështetje, udhëzime dhe këshilla për mësimehmënesit kolegë për t'iu dhënë mundësi atyre që të reflektojnë për praktikën e tyre profesionale, për përvojat në klasë dhe për t'iu dhënë mundësi t'i rrisin aftësitë e tyre mësimehmënese dhe të zhvillohen profesionalisht, përmes formave të ndryshme të mbështetjes dhe përfshirjes në ZHPBSH.

Për të udhëhequr zbatimin e ZHPMBSH, në funksion të zhvillimit të kompetencave në mësimehmënie, fillimisht duhen qartësuar mënyrat e ZHPMBSH, rolin e mësimehmënesit dhe veçoritë e procesit mësimor, në mënyrë që të përmirësohet dhe të avancohet praktika e mësimehmënies dhe procesi mësimor, që ato të jenë në përkrahjen e nxënësve në zotërimin e kompetencave kryesore dhe realizimin e potencialit të tyre.

Zbatimi nga shkolla i ZHPMBSH bëhet sipas:

- Prioriteteve dhe planit vjetor të shkollës për zhvillim profesional;
- Programeve të trajnimit dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara nga shkolla për zhvillim profesional në nivel shkolle;
- Formave të zhvillimit profesional të përcaktuara për realizim në kuadër të planit për zhvillim profesional në nivel shkolle.

Rikujtojmë se sipas UA për ZHPMBSH, programet e trajnimit të përcaktuara nga shkolla për zhvillim profesional në nivel shkolle, mund të realizohen në tri mënyra:

- Në përputhje me nevojat specifike të zhvillimit të saj, shkolla fillon hartimin e programeve të caktuara dhe i zhvillon ato vetë, ose në bashkëpunim me një shkollë tjetër. Aktivitetet e tjera të ZHPM, mund të përfshijnë mentorimin e mësimehmënesve, mbështetjen e kolegëve, organizimin e forumeve të ndryshme për shkëmbimin e përvojave ndërmjet mësimehmënesve në temat përkatëse (siç përcaktohet në planin shkollor të ZHPM), seancat e stërvitjes nga shërbimet profesionale të shkollave (nëse ka), etj. Programe të tilla të trajnimit nuk janë të domosdoshme të kalojnë përmes procedurave të miratimit/akreditimit nga MASHTI. Ato kalojnë në procesin e tillë, në rastet kur shkolla synon dhe përgatitet të jetë ofruese e trajnimeve edhe për mësimehmënes të shkollave të tjera në nivel komune dhe me gjerë.
- Shkolla merr një nga programet e akredituara dhe e zbaton atë me përfshirje të të gjithë mësimehmënesve të shkollave ose me grupe të mësimehmënesve të cilët kanë

shprehur nevojë dhe interesim për programe/t përkatëse të trajnimit (me miratimin paraprak formal të MASHTI-t dhe/ ose autorit të programit).

- Shkolla kërkon shërbim, përmes Drejtorisë Komunale të Arsimit, nga ofruesit e jashtëm të cilët janë të akredituar nga MASHTI për të ofruar aktivitete specifike për zhvillimin profesional të disa mësimdhënësve. Ofruesit e jashtëm ofrojnë programin e caktuar për mësimdhënësit e shkollave. Pjesë të programit mund të zbatohen nga mësimdhënësit pas trajnimeve, në formën e zbatimit praktik të përvetësimit të njohurive nga trajnimet e ndjekura.

Në secilën nga modalitetet, ekziston një rol kryesor i shkollës, ose në sigurimin e programit në tërësi ose në zbatimin e elementeve të caktuara të programit. Mësimdhënësit, pedagogët, profesionistët, drejtori dhe organi qeverisës i shkollës, luajnë një rol të rëndësishëm në zbatimin e zhvillimit profesional të shkollës.

Duhet t'i kushtohet vëmendje dallimit midis aktiviteteve joformale dhe formale të ZHP. P.sh. konsultimet joformale me kolegët për çështje të ndryshme që lidhen me praktikën e mësimdhënies në biseda të atypëratyshme kundrejt konsultimeve formale me mentorin, bazuar në një plan të veçantë mentorimi; pjesëmarrja dhe diskutimet në takimet e rregullta të Aktiveve Profesionale kundrejt pjesëmarrjes në forume të ndryshme për shkëmbimin e përvojave mes mësimdhënësve (që janë planifikuar në mënyrë specifike për adresimin e nevojave specifike të mësimdhënësve të identifikuar në nivel shkolle).

Pavarësisht nga forma në të cilën kryhet, të gjitha aktivitetet formale të ZHP mund të certifikohen për aq kohë sa ato janë të strukturuar siç duhet (bazuar në një program i cili përcakton qartë nevojat që duhet adresuar, rezultatet e pritshme, afatet kohore dhe mjetet e verifikimit në ndikimin që kishte në adresimin e nevojave) dhe kanë miratim nga organet përkatëse të shkollës dhe leje për përdorim nga MASHTI/KSHLM.

Në zbatimin e zhvillimit profesional me bazë në shkollë, bashkëpunimi ndërmjet shkollave të ndryshme në një formë të bashkësive të të mësuarit profesional, komuniteteve të mësuarit së bashku, është thelbësor. Kjo formë e rrjetëzimit dhe e shkëmbimit profesional mund të bëhet në forma të ndryshme duke filluar nga takimet e përbashkëta me ndarjen e ideve, përvojave dhe burimeve të përbashkëta. Gjithashtu, kjo formë e zhvillimit profesional, ndihmon shkollat në zhvillimin e kapaciteteve të tyre

për të zbatuar qasjen me bazë në shkollë si dhe pasuron idetë për aktivitete shitesë që shkolla mund të organizojë.

Për zhvillimin profesional të nxitur nga shkolla apo mësimdhënësi, temat që duhet të mbulohen duhet të jenë në nivel të njohurive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve të lidhura me disa aspekte të mësimdhënies, me praktika të avancuara të mësimdhënies, të cilat mësimdhënien e bëjnë cilësore, interaktive dhe gjithëpërfshirëse në punën me nxënës. Disa mund të përqendrohen në nevojat pedagogjike, siç janë vlerësimi, organizimi dhe menaxhimi i klasave, strategjitë e mësimdhënies, ose përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta. Aktivitete të tjera të zhvillimit profesional mund të shqyrtojnë përmbajtjen e lëndëve dhe proceset, siç janë shfrytëzimi efektiv i teknologjive kompjuterike, përdorimi i pajisjeve laboratorike dhe pajisjeve të tjera të specializuara që lidhen me një lëndë specifike. Për mësimdhënësit e shkollave të mesme, kjo mund të jetë një lëndë e vetme, si matematika ose biologjia. Për mësimdhënësit e shkollave fillore, fokusi mund të përfshijë metoda të integruara të mësimdhënies (Goddard, T. & Buleshkaj, O., 2018).

Kjo nënkupton se, format e zhvillimit profesional të mësimdhënësve me bazë në shkollë në masë të madhe varen nga programet e trajnimit të përzgjedhura në bazë të nevojave të mësimdhënësve për ta përmirësuar dhe avancuar praktikën e mësimdhënies, modulet dhe temat me prioritet për ZHP.

Rikujtojmë se format e ZHPMBSH të njohura edhe me UA përkatës, janë si në vijim:

- *Trajnime në nivel shkolle sipas programit të përzgjedhur nga shkolla, në përputhje me procedurat e brendshme dhe të jashtme;*
- *Punëtori dhe seminare;*
- *Mentorim nga trajnerë dhe mentorë të certifikuar;*
- *Këshillim dhe mentorim ndërmjet kolegëve;*
- *Kërkim/Hulumtim në veprim;*
- *Javë të zhvillimit profesional të mësimdhënësve;*
- *Pjesëmarrje në seminare, rrjete profesionale, konferenca, vizita studimore të ndërlidhura me planin individual për ZHPM dhe planin vjetor të shkollës për ZHPM.*

5.7. Monitorimi i brendshëm i aktiviteteve të ZHPBSH

Monitorimi i ZHPBSH realizohet në baza të rregullta nga vetë shkolla (nga drejtori i shkollës dhe koordinatori i cilësisë), sipas nevojës – specifikave të programeve të trajnimit që lidhen me MASHTI-n dhe ofruesit e jashtëm dhe specifikave të shkollave, si dhe në bazë të kërkesës së drejtorit të shkollës apo koordinatorit për sigurim të cilësisë në shkollë ose komunë.

Monitorimi duhet të bëhet në baza të rregullta nga personi/at përgjegjës i/të përcaktuar nga shkolla për ZHP me bazë në shkollë, përmes:

- Vëzhgimit të procesit të realizimit të aktiviteteve të zhvillimit profesional;
- Takimeve të rregullta mujore ose dy mujore me mësimdhënësit;
- Shqyrtimit të dosjeve profesionale të mësimdhënësve që pasqyrojnë elementet e aktiviteteve të zhvillimit profesional dhe vlerësimin eventuale të dosjeve;
- Konsultimit me aktivet profesionale dhe këshillat e klasave mbi ndikimin e aktiviteteve të ZHP në proceset mësimore dhe në të nxënë.

5.8. Raportimi i aktiviteteve të ZHPBSH

Çdo mësimdhënës, pas çdo aktiviteti të zhvillimit profesional në të cilin ai/ ajo ka qenë i përfshirë (siç është planifikuar me planin ZHPM të shkollës), duhet të ofrojë dëshmitë verifikuese të pjesëmarrjes dhe suksesit të arritur në portofolin e tij/ saj për ZHP.

E njëjta gjë duhet të bëhet nga shkolla për mësimdhënësit që kanë marrë pjesë në trajnime ose në ndonjë aktivitet të zhvillimit profesional (qoftë i aprovuar nga KSHLM). Shkolla/ mësimdhënësit ofrojnë dëshmi për zbatimin e ZHPBSH në përputhje me dispozitat e MASHTI-t dhe respektimin e kushteve të akreditimit të secilit program nga MASHTI. Provat përfshihen në portofolin profesional të lidhur drejtpërdrejt me aktivitetin/aktivitetet e ndjekura. Ato mund të jenë:

- Plane mësimore me qasjet dhe strategjitë e zhvilluara dhe të përvetësuara në punëtori, trajnime dhe forma të tjera të zhvillimit profesional (së paku 5);

- Reflektime të mësimdhënësit nga aktivitetet e ZHP dhe nga praktikat e klasës në ndërlidhje me këto aktivitete;
- Fotografi dhe materiale të tjera pamore nga ora/ klasa duke reflektuar aktivitete konkrete dhe lidhjen e tyre me qasjet dhe strategjitë e zhvilluara dhe të përvetësuara në punëtori, trajnime dhe forma të tjera të zhvillimit profesional;
- Produkte të aktiviteteve (mostër e punës së nxënësve, etj.);
- Fletëvlerësime të nxënësve;
- Procesverbale të ndryshme të seancave të punës e të reflektimit;
- Apo edhe lloje të tjera të dëshmive varësisht nga specifikat e programit dhe aktiviteteve të ZHP.

Dëshmia u shërben mësimdhënësve individualë në procesin e certifikimit, në përputhje me kushtet për aprovimin e programit. Dëshmitë gjithashtu mund të shërbejnë për të hartuar raporte shkollore për Drejtorinë Komunale të Arsimit. Dëshmitë e grumbulluara verifikohen nga drejtori i shkollës ose nga një person tjetër i autorizuar nga DKA. Në varësi të kërkesave dhe dispozitave ligjore, dëshmitë e tilla mund t'i përcillen departamentit përkatës në MASHT, të regjistrohen në bazën e të dhënave të MASHTI-t për licencim ose të paraqiten në Drejtorinë Komunale të Arsimit, partnerit zhvillimor ose komunitetit.

Në nivel shkolle përgatiten raporte përmbledhëse pas përfundimit të çdo programi të trajnimit dhe pas çdo aktiviteti tjetër të realizuar në nivel shkolle në bazë të planit për zhvillim profesional me bazë në shkollë. Raportet e tilla hartohen nga përgjegjësi kryesor i programit, aktiviteti përkatës i ZHP. Pastaj, mbi bazën e këtyre raporteve hartohet raporti vjetor përmbledhës për ZHPMBSH. Raporti vjetor në nivel shkolle, hartohet nga koordinatori i caktuar apo koordinatori i cilësisë për ZHPMBSH.

5.9. Certifikimi me bazë në shkollë

Zhvillimi profesional me bazë në shkollë, është i veçantë për çdo shkollë edhe në raport me certifikimin, për faktin se për ZHPMBSH certifikimi bëhet nga vetë shkolla, por edhe nga MASHTI dhe ofruesit e jashtëm.

Në pjesën e pestë të këtij udhëzuesi, ofrohen më shumë informacione për certifikimin me bazë në shkollë.

6. PROCEDURAT E JASHTME - PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË -ZHPBSH

Për qëllime praktike, procesi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë është ndarë në procedurat e brendshme (shkollore) dhe të jashtme (mbështetëse). Kjo ndarje pasqyron një situatë në të cilën një shkollë planifikon, zbaton dhe vërteton zhvillimin profesional të mësimitdhënësve në nivel shkolle, ndërsa institucionet dhe autoritetet e tjera të arsimit përgjegjës (DKA, MASHTI, IPK, FE) sigurojnë monitorim dhe mbështetje për këtë proces. Në këtë skemë, DKA përfaqëson ndërlidhjen mes shkollave dhe autoriteteve të arsimit të nivelit qendror, nëpërmjet funksioneve të saja si fasilituese, garantuese e cilësisë dhe vërtetuese e të gjithë procesit.

Megjithatë zhvillimi profesional me bazë në shkollë është relativisht i ri në shkollë, do të jetë e nevojshme që secila shkollë të mbështetet përmes procedurave të jashtme. Këto procedura shërbejnë për të vërtetuar dhe njohur përkushtimin e mësimitdhënësve për zhvillimin profesional personal, për të siguruar informacion të besueshëm, për të ofruar mbështetje adekuate për zhvillimin profesional me bazë në shkollë dhe për të rishikuar dhe avancuar proceset arsimore dhe zhvillimore të shkollës.

Procedurat e jashtme përfshihen në këtë udhëzues në mënyrë që shkollat të jenë mirë të informuara në lidhje me mbështetjen, monitorimin dhe procedurat e tjera në të cilat do të ekspozohen gjatë procesit. Procedurat e jashtme përfshijnë: **mbështetje, monitorim, verifikim, certifikim dhe vlerësim për zbatimin e aktiviteteve për ZHPMBSH. Referuar UA për ZHPMBSH, procedurat e jashtme zbërthehen si në vijim:**

- Mbështetja për ZHPMBSH bazohet në qasjen e drejtuar nga kërkesa e shkollës dhe mësimitdhënësve me synimin që të adresohen aspektet e nevojshme për përmirësimin e praktikave të mësimitdhënies.
- Monitorimi i jashtëm i ZHPMBSH, ka për qëllim të sigurojë informacion të besueshëm dhe të detajuar për të shqyrtuar proceset dhe për të mbështetur shkollat në zbatimin e suksesshëm të zhvillimit profesional me bazë në shkollë.
- Verifikimi i ZHPMBSH ka për qëllim të vërtetojë realizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional dhe përmbushjen e kritereve të përcaktuara në programet përkatëse të aprovuara nga Këshilli Shtetëror për Licencim të Mësimitdhënësve

(KSHLM) dhe të përmbushjes së kriterëve të programeve të realizuara nga shkolla.

- Certifikimi realizohet sipas procedurave të përcaktuara me UA.
- Vlerësimi ofron të dhëna për përmbushjen e kërkesave për aktivitete të ZHPMBSH dhe përmirësimin e praktikave të mësimdhënies si rezultat i aktiviteteve të ofruara apo të organizuara.

6.1. Mbështetja e ZHPMBSH

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve me bazë në shkollë, bazohet në qasjen e drejtuar nga nevojat e mësimdhënësve, të cilat ndërlidhen me kompetencat në procesin e mësimdhënies, kërkesat për ZHP në kuadër të sistemit të licencimit të mësimdhënësve, por edhe me prioritetet e MASHTI-t për zhvillimin e mësimdhënësve. Në këtë drejtim, MASHTI, mbështet shkollën me synimin për të mbështetur ZHPM me bazë në shkollë përmes:

- Zbërthimit të kompetencave të mësimdhënësve në kriterë cilësorë dhe tregues të matshëm që do të udhëzonin punën e mësimdhënësve, por edhe vlerësimin e performancës së tyre;
- Ofrimit të udhëzimeve, mjeteve dhe materialeve shtesë që u vihen në dispozicion mësimdhënësve si dokumente burimore për ZHPM në nivel shkolle, në mënyrë që ata të mund të kuptojnë, të përvetësojnë dhe të zbatojnë qasjen e kompetencës.
- Përfshirjes së kompetencave të mësimdhënësve në programe specifike të zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve që ofrohen nga ofruesit e tjerë të programeve të ZHPM, në mënyrë që shkollat/ komunat të kenë zgjedhje të përshtatshme për përzgjedhjen e aktiviteteve të ZHPM.
- **Ndarjes së buxhetit për aktivitetet e zhvillimit profesional, duke siguruar një linjë buxhetore specifike, megjithëse formula aktuale nuk e pengon komunën/ shkollën që të ndajë buxhet për aktivitetet e zhvillimit profesional nga kategoria e buxhetit mallra dhe shërbime.**

- Miratimit dhe pranimi të zhvillimit profesional me bazë në shkollë për të përmbushur kërkesat e licencimit. Lidhja midis zhvillimit profesional të shkollës dhe sistemit të licencimit të mësimdhënësve do të inkurajojë shkollat të marrin iniciativa për zhvillimin me bazë në shkollë.

Kjo nënkupton: **shkolla në varësi të nevojave të saj, duhet të kërkojë mbështetjen nga MASHTI përmes DKA-s, për programe dhe nisma të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, që ndërlidhen me procedurat e jashtme.**

6.2. Monitorimi

Shkolla dhe mësimdhënësit tashmë janë të informuar që ZHPBSH është i lidhur me kërkesat e ZHPM për sistemin e licencimit të mësimdhënësve. Për të siguruar ndërlidhje dhe efektivitet të ZHPBSH, monitorimi i jashtëm është proces i pashmangshëm.

Pra, shkollat dhe mësimdhënësit duhet t'u përgjigjen kërkesave të procedurave të jashtme për monitorimin e ZHPMBSH, në mënyrë që të sigurohet akreditimi kur është i nevojshëm, dhe pranimi i zhvillimit profesional me bazë në shkollë.

Siç është thënë më lartë, monitorimi i jashtëm i zhvillimit profesional me bazë në shkollë ka për qëllim të sigurojë informacion sa më të besueshëm dhe të detajuar për të shqyrtuar proceset dhe për të mbështetur shkollat në zbatimin e suksesshëm të zhvillimit profesional.

Monitorimi i rregullt i ZHPBSH nga DKA-të zbatohet përmes:

- Takimeve të rregullta tremujore me mentorin e ZHP dhe drejtorin e shkollës për të monitoruar procesin e zbatimit të planit të shkollës për ZHPM, për të diskutuar sfidat dhe për të identifikuar veprimet korrigjuese;
- Vizitat monitoruese ad-hoc në shkolla për të vëzhguar modelin e mësimdhënësve me qëllim të diagnostikimit të realizimit të aspekteve të sesioneve të zhvillimit profesional në praktikën profesionale të mësimdhënësve, të konsultohet me mësimdhënësit individualë dhe/ ose strukturat shkollore mbi efektivitetin e aktiviteteve e ZHP;

- Me kërkesë të drejtorit të shkollës, koordinаторit të sigurimit të cilësisë ose mentorit të ZHP.
- Monitorimi i jashtëm i zhvillimit profesional me bazë në shkollë është i organizuar edhe nga:
- Ofruesi i ZHPBSH (nëse programi ofrohet nga një ofrues i jashtëm);
- MASHTI (zyrtarët e sektorit të trajnimit të mësimeve, zyrtarët e kurrikulës, etj.).

Monitorimi bëhet në përputhje me planin e monitorimit. Plani i monitorimit përfshin analizën dhe rishikimin për:

- Planin e shkollës për ZHPBSH;
- Aktivitetet përgatitore për zhvillimin e seancave të zhvillimit profesional;
- Realizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional;
- Praktikat e mentorimit të facilituesve shkollor me mësimeve kolegjë për zbatimin e përvojave të trajnimit në praktikën e mësimeve, realizimin e mësimeve;
- Dosjet profesionale të mësimeve që reflektojnë parimet dhe elementet e aktiviteteve të zhvillimit profesional si dhe vlerësimin eventuale të dosjeve;
- Vëzhgimin e një mostre të mësimeve me qëllim të diagnostikimit të realizimit të aspekteve të seancave të zhvillimit profesional në praktikën profesionale të mësimeve.

Partnerët e përfshirë në procesin e monitorimit të ZHPBSH konsultohen me drejtorin e shkollës dhe koordinatorin e shkollës për ZHPBSH para realizimit të planit të monitorimit. Një konsultim i tillë duhet të përqendrohet në dinamikën e aktiviteteve për monitorimin e ZHPBSH, si dhe në nevojat specifike të shkollës për monitorim me qëllim të ofrimit të mbështetjes në përmirësimin e cilësisë së trajnimeve me bazë në shkollë. Vëzhguesit e jashtëm duhet të përgatisin raporte monitorimi, duke përfshirë orientime e sugjerime për përmirësimin/ promovimin e shkollave dhe masat mbështetëse për ZHPBSH dhe dokumentimin e tyre (përmes raporteve) për nevojat e verifikimit dhe certifikimit si dhe për rezultatet e vlerësimit mbi ndikimin e ZHPBSH në përmirësimin dhe avancimin e cilësisë së mësimeve dhe të mësuarit në shkollë.

6.3. Verifikimi

Procesi i verifikimit të ZHPBSH ka për qëllim të vërtetojë realizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional dhe përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në programin përkatës të akredituar nga KSHLM. Verifikimi ndryshon nga monitorimi sepse konfirmon provat e ofruara dhe aktivitetet e kryera nga shkolla dhe mësimdhënësit. Monitorimi i referohet programeve, aktiviteteve dhe kurseve, ndërsa verifikimi merret me prova/dëshmi për faza të ndryshme të realizimit të zhvillimit profesional të mësimdhënësve individualë.

Portfolio e zhvillimit profesional personal dhe raportet e monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm, konsiderohen mjetet kryesore që e ushqejnë procesin e verifikimit të ZHPBSH.

Verifikimi i ZHPBSH bëhet nga një person i autorizuar nga Drejtori i Komunës për Arsim. Ky person duhet të jetë Koordinator i Sigurimit të Cilësisë, ose në rast të një vëllimi të madh të punës në këtë fushë, një i deleguar nga DKA-ja. Nëse delegohet, ky delegim i detyrave mund të transferohet te zyrtarë të tjerë të nivelit komunal të cilët janë të përgatitur për këtë proces ose tek ekspertë të tjerë të fushës së edukimit, siç janë edhe pedagogët, të cilët mund të angazhohen nga Komuna për shërbime në nivel komunal.

Kjo nënkupton,

Kultivimin e një kulture organizative të shkollës dhe të mësimdhënësve individualë, për vëmendjen e duhur ndaj evidencave dhe dëshmimeve për procesin e ZHPBSH, për kujdesin që duhet të kenë mësimdhënësit individualë për të dëshmuar zhvillimin e tyre me porfolion e zhvillimit profesional, duke përfshirë planifikimin, zbatimin e mësimëve dhe reflektimin në ndërlidhje me aktivitetet e ZHP.

Certifikimi

ZHPMBSH siç është përshkruar më lart, lidhet me procedurat e jashtme që mbështesin këtë proces. Rrjedhimisht edhe certifikimi për disa programe të trajnimit të cilat shkolla i merr nga lista e programeve të lejuara nga MASHTI/KSHLM për nevojat e ZHPMBSH, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga MASHTI/KSHLM për certifikimin e mësimdhënësve në programet përkatëse.

Në pjesën e pestë të këtij udhëzuesi, ofrohen më shumë informacione për certifikimin me bazë në shkollë.

6.4. Vlerësimi

Zhvillimi profesional me bazë në shkollë, është një qasje e re për arsimin në Kosovë dhe do të kërkojë vëmendje të veçantë në vitet e para të zbatimit të tij. Ky fokus i vlerësimit nuk është i orientuar drejt gjykit cilësor, por në drejtim të ofrimit të reflektimit dhe rekomandimeve që rezultojnë në përmirësimin e aktiviteteve në fjalë.

Kjo nënkupton,

Shkolla duhet të përgatitet për vlerësimin e procesit të ZHPBSH, që të përfitojë nga ky proces dhe ta përmirësojë e ta avancojë atë.

Procesi i vlerësimit ndryshon nga monitorimi i ZHPBSH, për faktin se vlerësohet i gjithë procesi i ZHPBSH, duke përfshirë:

- Efektivitetin dhe efikasitetin e qasjeve me bazë në shkollë;
- Ndikimin e ZHPBSH në përmirësimin e mësimdhënies dhe arritjeve të nxënësve;
- Qëndrueshmërinë e qasjes së ZHPBSH; dhe,
- Rëndësinë e aktiviteteve të ZHPBSH për reformimin dhe zbatimin e politikave të arsimit.

Vlerësimi i këtyre aspekteve mbështetet në:

- Shqyrtimin e planeve shkollore për zhvillim profesional dhe plane të tjera të zhvillimit;
- Raportet e rregullta të punës nga palët e interesit, të përfshira në procesin e ZHPBSH,
- Raportet e monitorimit;
- Dëshmitë e fituara përmes instrumenteve të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit;

- Portfoliot individuale të zhvillimit profesional të mësimeve; dhe,
- Reflektimet dhe opinionet e mësimeve dhe të akterëve të tjerë, të dhëna përmes instrumenteve të ndryshme (sondazhe, intervista, fokus grupe, etj).

Rezultatet dhe rekomandimet e nxjerra nga vlerësimi i ZHPBSH duhet t'u shërbejnë të gjitha palëve të përfshira në procesin e ZHPBSH, gjithnjë në funksion të përmirësimit dhe avancimit të cilësisë së ZHPM dhe reflektimit të këtij procesi në rezultatet dhe arritjet e nxënësve.

7. PROCEDURAT DHE KRITERET E CERTIFIKIMIT TË ZHPMBSH

Qasja dhe format e ZHPMBSH zhvendosin fokusin nga presioni për certifikata për përmbushjen e kriterëve të kërkuara me sistemin e licencimit të mësimeve, në zhvillimin e kompetencave të mësimeve lidhur me praktikën e punës në klasë dhe në bazë të nevojave individuale.

Kjo qasje u garanton shkollave një autonomi substanciale të vendimmarrjes për programet dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimeve si dhe për organizimin e ZHPM në funksion të zhvillimit të kompetencave të tyre. Gjithashtu, kjo qasje funksionon edhe brenda përcaktimeve të sistemit të licencimit të mësimeve, sipas të cilit nga viti 2021, 50 % e kërkesave për zhvillim profesional të mësimeve plotësohen nga ZHPMBSH.

Procedurat e certifikimit të ZHPMBSH ndërlidhen me programet dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë. Në varësi të programeve dhe aktiviteteve, autorësisë së tyre dhe të lejes për përdorim, bëhet edhe certifikimi i mësimeve të përfshirë në ZHPBSH.

Referuar specifikave të ZHPMBSH dhe procedurave të certifikimit të përcaktuara me UA përkatës, aplikohen disa mënyra të certifikimit të mësimeve të përfshirë në programet dhe në aktivitetet e ZHPBSH, të cilat ndërlidhen me qasjen e ofrimit të programeve në nivel shkolle:

- Për programet e trajnimit dhe aktivitetet e ZHPM që janë hartuar në nivel shkolle, janë miratuar nga KDSH dhe janë verifikuar nga DKA, certifikimin e

mësimdhënësve e bën vetë shkolla me nënshkrim të drejtorit të shkollës dhe koordinatorit të cilësisë ose mentorit për ZHPMBSH;

- Për programet dhe aktivitetet e ZHP që janë realizuar në kuadër të programeve të trajnimit dhe aktiviteteve të ZHP të inicuar nga DKA, certifikimi bëhet nga drejtori i shkollës përkatëse dhe koordinatori për cilësi ose zyrtari për ZHP në DKA;
- Ndërsa, certifikimi i mësimdhënësve për programet të cilat shkolla i merr nga lista e programeve të lejuara nga MASHTI/KSHLM për nevojat e ZHPMBSH, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara nga MASHTI/KSHLM për certifikimin e mësimdhënësve në programet përkatëse.

Certifikimi që bëhet nga vetë shkolla dhe nga DKA, bëhet në bazë të kriterëve në vijim:

- Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara me bazë në shkollë sipas planit dhe kërkesave të programit, të aprovuar nga institucioni përkatës;
- Vlerësimi i portfolios personale të zhvillimit profesional, e cila përgatitet sipas kriterëve të përcaktuara nga programi, me dëshmi nga zbatimi në praktikat në klasë;
- Vlerësimi i portfolios së mësimdhënësit, të cilin e bën personi i përcaktuar me kriteret e programit përkatës të zhvilluar në nivel shkolle apo nga DKA.
- Raportet nga procesi i konsultimeve me kolegë, mentorë, me koordinatorin e cilësisë dhe me udhëheqësit e aktiviteteve për ZHP, të cilat evidencohen në raportin për zbatimin e aktiviteteve për ZHPMSH.

Prandaj,

Dëshmitë e realizimit të ZHPMBSH janë të rëndësishme për certifikim, ato duhet të ruhen në nivel shkolle, sepse mund të jenë objekt i shqyrtimit dhe i verifikimit nga shkolla – komisioni i themeluar nga KDSH, MASHTI, Inspektorati i Arsimit dhe nga DKA.

Certifikatat që lëshohen nga shkolla dhe DKA duhet të përmbajnë logon e shkollës dhe të DKA, të dhënat për mësimdhënësin që certifikohet, numrin e orëve të ZHP, temat/modulet e programit dhe hapësirat për nënshkruesit zyrtarë.

Një certifikatë e lëshuar nga shkolla dhe DKA, mund të përmbajë disa tema/module të cilat janë mbajtur brenda një viti shkollor. Kjo nënkupton që nuk ka nevojë që për çdo formë të zhvillimit profesional të lëshohet certifikatë, ato mund të integrohen në një certifikatë vjetore të ZHPMBSH.

Kini kujdes!

Ndaj çdo keqpërdorimi apo shkeljeje ligjore të certifikimit pa merita dhe pa dëshmi, ngrihen procedura të masave disiplinore dhe të ndëshkimeve sipas procedurave ligjore në fuqi

Dëshmitë e certifikimit të mësimdhënësve për ZHPMBSH ruhen në nivel shkolle dhe janë objekt i shqyrtimit dhe verifikimit nga shkolla – komisioni i themeluar nga KDSH, MASHT, Inspektorati i Arsimit dhe nga DKA. Ato mund të jenë si në vijim:

- Plani vjetor i shkollës për ZHPMBSH;
- Listat e pjesëmarrjes në programe të trajnimit dhe aktivitete tjera të ZHPMBSH;
- Raportet e vlerësimit të portofoliove të mësimdhënësve për ZHP;
- Certifikatat nga ZHPMBSH;
- Raportet e lidhura me ZHPMBSH.

8. STRUKTURAT MBËSHTETËSE TË ZHPBSH

Strukturat mbështetëse për ZHPMBSH bazohen në nevoja për zhvillim profesional, në kapacitetet dhe burimet në dispozicion të institucioneve që kanë role dhe përgjegjësi në ZHPMBSH. Ato përbëhen nga strukturat mbështetëse:

- në nivel shkolle;
- në nivel komune – Drejtorisë Komunale për Arsim; dhe
- në nivel qendror.

8.1. Strukturat mbështetëse në nivel shkolle

ZHPMBSH është një qasje zhvillimore e cila bazohet në funksionalizimin e strukturave të shkollës siç janë: drejtori i shkollës, Këshilli drejtues i shkollës, koordinatori i cilësisë, aktivet profesionale, këshillat e klasës, shërbimi pedagogjik-psikologjik në shkollë, si

dhe ekipet ose organet këshilluese në nivel shkolle, të cilat mund të themelohen nga KDSH për nevojat e ZHPMBSH.

Procesi i ZHPMBSH kërkon aktivizimin e të gjitha kapaciteteve dhe strukturave në dispozicion. Kjo sepse ZHPBSH fillon, zbatohet dhe vlerësohet në shkollë. Përveç kësaj, do të nevojiten struktura të reja për të mbushur boshllëqet profesionale, strukture dhe funksionale midis drejtorit të shkollës dhe mësimdhënësve, me synimin për të ofruar më shumë mbështetje për zhvillimi profesional të mësimdhënësve.

Duke qenë se qasja e zhvillimit profesional me bazë në shkollë është specifike për shkollën përkatëse, secila shkollë do të duhet të funksionalizojë dhe t'i ndërtojë strukturat dhe mekanizmat e duhura që u përshtaten më mirë nevojave të saj të zhvillimit, por edhe kapaciteteve dhe burimeve të disponueshme. Është e rëndësishme të realizohen funksionet dhe procedurat e parashikuara në këtë dokument.

Drejtori i shkollës

Drejtori i shkollës është personi udhëheqës dhe menaxherial kryesor i shkollës, si në aspektin e ecurisë së procesit të mësimdhënies dhe në menaxhimin e proceseve në shkollë. Pra, edhe në fushën e zhvillimit profesional, drejtori ka kompetencën kryesore për të kryer aktivitete të zhvillimit profesional, të mbështetura nga të gjitha strukturat e tjera relevante të shkollës. Drejtori siguron që ekipi i shkollës të jetë funksional dhe të kryejë aktivitete sipas planit shkollor për ZHPM. Drejtori është gjithashtu një urë midis strukturave të zhvillimit profesional në shkollë dhe strukturave të jashtme relevante (kryesisht ato komunale).

Në kuadër të zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca, drejtori i shkollës duhet të shoqërojë procesin e ndryshimit duke u siguruar që i gjithë stafi të marrë kohë të mjaftueshme për të zhvilluar praktikën e tyre dhe për të mbështetur kolegët e tyre që kontribuojnë në një mjedis pune që inkurajon bashkëpunimin dhe inovacionin.

Këshilli drejtues i shkollës

Këshilli drejtues i shkollës (KDSH) është organ këshillëdhënës dhe është organi kryesor vendimmarrës i shkollës. Brenda kompetencave të përgjithshme, KDSH gjithashtu

ushtron funksione të ndryshme në fushën e zhvillimit profesional të mësimeve. Ndër të tjera, KDSH:

- ▶ Inicion zbatimin e procedurave të zhvillimit profesional me bazë në shkollë;
- ▶ Autorizon hartimin dhe miratimin e planeve të zhvillimit profesional;
- ▶ Shqyrton dhe miraton raportet e punës së drejtorit dhe ekipit të shkollës për ZHP lidhur me aktivitetet e ZHP në shkollë;
- ▶ Miraton buxhetin për zhvillimin profesional në shkollë, në bazë të planit të zhvillimit të shkollës;
- ▶ Emëron anëtarët e ekipit të shkollës në konsultim me drejtorin e shkollës dhe këshillin e mësimeve.
- ▶ Rishikon PZSHSH dhe adapton / avancojnë në funksion të ZHP, duke planifikuar masa dhe aktivitete konkrete për ZHPBSH

Koordinatori i cilësisë

Koordinatori i cilësisë në shkollë, është person përgjegjës për sigurimin e cilësisë në shkollë, proces i cili ndërlidhet ngushtë me procesin e zbatimit të kurrikulës, sipas UA nr. 24/2016 për Sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar.

Ndër të tjera, koordinatori i cilësisë së shkollës:

- ▶ Planifikon, organizon dhe monitoron procesin e sigurimit të cilësisë së shkollës në bashkëpunim me drejtorin e shkollës;
- ▶ Ndhmon drejtorin e shkollës dhe organet qeverisëse e profesionale të shkollës në procesin e hartimit të planit zhvillimor të shkollës dhe të planit të veprimit për përmirësim;
- ▶ Informon drejtorin e shkollës dhe mësuesin për çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e cilësisë në shkollë;
- ▶ Bën identifikimin e nevojave për zhvillim profesional të mësuesve.

Gjithashtu, koordinatori i cilësisë në shkollë në bashkëpunim me ekipin për vlerësimin e performancës së shkollës realizon procesin e vetëvlerësimit, inicion dhe mbështet planin e përmirësimit, si dhe mbështet punën e ekipeve profesionale që

themelohen në nivel shkolle, si për zhvillimin e shkollës ashtu edhe të ekipit për zhvillim profesional të mësimeve.

Ekipi për zhvillimin profesional me bazë në shkollë

Jo të gjitha shkollat kanë ekipe për zhvillim profesional të mësimeve me bazë në shkollë. Disa shkolla kanë Ekipin për zhvillim të integruar të shkollës. Këto ekipe (Ekipi për zhvillimin profesional me bazë në shkollë ; Ekipi për zhvillim të integruar të shkollës), sipas Ligjit për arsimin parauniversitar në Kosovë (2011), neni 17, paragrafinr. 13, themelohen nga KDSH, me propozimin e drejtorit të shkollës dhe kanë mandat këshillues brenda shkollës, në fusha tematike me prioritet për shkollën.

Si ilustrim për të përshkruar rolin e ekipeve të tilla profesionale, po e marrim Ekipin për zhvillimin profesional me bazë në shkollë, pasi që me këtë emërtim, në një numër të madh të shkollave është punuar nga Programi për Arsim Themelor (PATH) i ofruar nga USAID-KEC për themelimin dhe ngritjen e kapaciteteve të tyre dhe është shumë më e lehtë të riorganizohen ato.

Ekipi për Zhvillimi Profesional me bazë në shkollë (Ekipi i ZHPBSH) është një lidhje që ndihmon drejtorin e shkollës në lehtësimin e aspekteve profesionale/ akademike të punës së tij/ saj. Themelimi i ekipit të shkollës duhet të bëhet me vendim të bordit drejtues të shkollës dhe përmes një procesi konsultativ me drejtorin e shkollës dhe me këshillin e mësimeve. Ekipi i ZHPBSH kryen punën nën drejtimin e drejtpërdrejtë dhe nën mbikëqyrjen e drejtorit të shkollës.

Struktura e ekipit të ZHPBSH duhet të jetë fleksibile, që të mundësojë adresimin e specifikave të shkollave individuale (të vogla/ të mëdha, të mesme/ primare, të përgjithshme/ profesionale, etj.). Një strukturë e mundshme e ekipit të shkollës përbëhet nga pedagogu shkollor (nëse shkolla e ka një të tillë), tre deri në pesë fasilitues/ trajnues të shkollave dhe një mësues i shquar për performancë të shkëlqyeshme. Përbërja e ekipit të shkollës duhet të reflektojë mbi planin e shkollës për ZHPM në mënyrë që të mund të adresojë nevojat e mësimeve për ZHP. Në rastin e shkollave të vogla, ekipi i shkollës mund të organizohet në bashkëpunim me një shkollë tjetër aty pranë. Në raste të tilla, planifikimi i zhvillimit profesional duhet të bëhet bashkërisht dhe duhet të realizohet bashkërisht. Në rastin e shkollave që konsiderohen të mëdha, p.sh. me rreth 100 mësues, mund të organizohet një ekip

shkolle që përbëhet nga një nën-strukturë për nivelin fillor dhe një nën-strukturë për nivelin e ulët për shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, ndërsa për shkolla të mesme të larta mund të përdoren kriteret e "ndërrimit" për organizimin e ekipit të shkollës.

Detyra kryesore e Ekipit të ZHPBSH është që të mbështesë zbatimin e planit ZHPM me bazë në shkollë, si mentor dhe/ ose si fasilitues i aktiviteteve të ndryshme të ZHPM (trajnime me bazë në shkollë, shkëmbimi i seancave brenda shkollës dhe/ ose me shkolla të tjera, shkëmbimi i mentorëve me shkolla të tjera) dhe si organizator i aktiviteteve të ZHPM që mund të ofrohen nga Drejtoria Komunale e Arsimit dhe/ ose të jepen nëpërmjet Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Mentor i Zhvillimit Profesional

Mentori i Zhvillimit Profesional (Mentori i ZHP) zgjidhet nga anëtarët e ekipit profesional që është funksional në nivel shkolle, që organizon aktivitetet e ZHPBSH. Ai/ ajo është pika qendrore për çdo shqetësim që mësime dhënësit kanë në lidhje me performancën e tyre. Mentori i ZHP është një urë në mes të ekipit të ZHPBSH dhe drejtorit të shkollës në njërin anë dhe mësime dhënëse dhe ekipit të ZHPBSH nga ana tjetër. Në mënyrë të veçantë, Mentori i ZHP kryen detyrat e mëposhtme:

- ▶ Shërben si një ndërlidhës mes mësime dhënëse dhe ekipit të ZHPBSH;
- ▶ Koordinon punën dhe aktivitetet e ekipit të ZHPBSH, bazuar në planin e ZHPM dhe në bazë të nevojave ad-hoc që mund të dalin;
- ▶ Mbështet dhe lehtëson procesin e identifikimit të nevojave të mësime dhënëse për ZHPBSH;
- ▶ Mbështet mësime dhënësit në hartimin e planeve individuale për zhvillim profesional;
- ▶ Koordinon aktivitetet për hartimin e kurrikulave shkollore për zhvillim profesional;
- ▶ Ndjek zbatimin e planit të ZHPBSH;
- ▶ I raporton mbi punën teknike të ZHPBSH, drejtorit të shkollës dhe zyrtarëve të tjerë të duhur.

Prandaj,

Mentori për zhvillim profesional të mësimeve me bazë në shkollë, zgjidhet në bazë të disa kriterëve, të cilat që në fillim sigurojnë parakushte elementare për përmbushjen e rolit dhe detyrave të tij/saj. Kriteret për përzgjedhje janë: (1) Mësimeve i dalluar dhe i përkushtuar për të mbështetur kolegët; (ii) Mësimeve i certifikuar për trajner dhe mentor, që ka referencë afirmative për të ushtruar këtë rol; (iii) Mësimeve që ka shkathtësi komunikuese dhe për punë në ekip; (iv) Mësimeve që ka qëndrime pozitive ndaj ndryshimeve arsimore gjithandej dhe zhvillimeve në shkollë.

Aktivitetet profesionale:

Aktivitetet profesionale (AP) janë organe profesionale të shkollës të themeluara dhe të funksionalizuara sipas legjislacionit përkatës dhe të organizuara në nivel shkolle, sipas specifikave dhe veçantive të shkollave sipas përcaktimeve në Udhëzimin administrativ 22/2016 për Aktivitetet Profesionale (Departamentet) të shkollave.

Aktivitetet profesionale janë strukturë e mesme e udhëheqjes në shkollë me qëllim të sigurimit të cilësisë dhe performancës së mirë të shkollës. Ato kujdesen për mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor në nivel të fushës/fushave kurrikulare, pritjeve në nivel të fushës, matjes së rezultateve të pritura, hartimin e instrumenteve të përbashkëta të vlerësimit, krijimit të materialeve dhe mjeteve mësimore, ndarjes së përvojave dhe praktikave të mira, mentorimit dhe monitorimit të procesit mësimor⁷.

Roli i tyre në lidhje me ZHPBSH mund të përfshijë:

- ▶ Vlerësimin e nevojave për aktivitetet e ZHP në lidhje me mësimeve të lëndëve përkatëse (të mbuluara nga AP përkatëse); ky vlerësim i nevojave bazohet në monitorimin e rregullt nga ana e AP për zbatimin e kurrikulës për fushat përkatëse të kurrikulës duke përfshirë identifikimin e sfidave në zbatimin e kurrikulës.

⁷ Devetaku, H. (2018). Doracaku për Aktivitetet Profesionale në shkollat e Kosovës – roli dhe funksioni i tyre (GIZ, 2018).

- ▶ Organizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional me mësimdhënësit e lëndëve përkatëse (aktivitetet mbështetëse ndër-kolegjiale, forumet e shkëmbimit për çështjet që kanë të bëjnë me zonën specifike të kurrikulës, etj.);
- ▶ Monitorimin e ndikimit të aktiviteteve të ZHP në proceset e mësimdhënies dhe mësimin të mësimdhënësve individualë, si pjesë e takimeve të rregullta të tyre.

Këshillat e Klasës

Këshillat e Klasës (KK) organizohen për të vepruar në përputhje me rregulloret përkatëse. Roli i tyre në lidhje me ZHPMBSH mund të përfshijë:

- ▶ Vlerësimin e nevojave për aktivitetet e ZHPM lidhur me mësimdhënësit e klasës përkatëse (të mbuluar nga KK përkatëse); ky vlerësim i nevojave bazohet në monitorimin e rregullt nga KK të zbatimit të kurrikulave për fazat përkatëse të kurrikulës duke përfshirë identifikimin e sfidave për zbatimin e kurrikulës.
- ▶ Organizimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional me mësimdhënësit e klasave përkatëse (aktivitete mbështetëse ndër-kolegjiale, forumet e shkëmbimit për çështjet që shqetësojnë në lidhje me fazën specifike të kurrikulës, etj.);
- ▶ Monitorimin e ndikimit të aktiviteteve të ZHP në proceset e mësimdhënies dhe mësimin të mësimdhënësve individualë, si pjesë e takimeve të rregullta të tyre;

Shërbimi pedagogjik - psikologjik në shkollë

Monitorimi dhe mbështetja e performancës së personelit mësimor është një nga funksionet kyçe të shërbimit pedagogjik - psikologjik në shkollë. Gjatë këtyre proceseve ato gjithashtu mund të kontribuojnë në:

- ▶ Vlerësimin e nevojave për aktivitetet e ZHP;
- ▶ Identifikimin e mësimdhënësve që mund të ofrojnë mbështetje për zhvillimin profesional të kolegëve të tyre;

- ▶ Monitorimin e ndikimit të aktiviteteve të ZHP në proceset e mësimdhënies dhe të mësimi;

Shërbimet profesionale gjithashtu mund:

- ▶ Të kontribuojnë në zhvillimin e planit me bazë në shkollë për ZHPM;
- ▶ Zbatojnë aktivitete të ndryshme të zhvillimit profesional (organizim, lehtësim dhe/ ose ofrim të aktiviteteve të ZHP për mësimdhënësit).

Sa i përket strukturave mbështetëse në nivel shkolle për ZHPBSH, udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që:

për çdo strukturë në nivel shkolle duhet të përcaktohen qartë detyrat dhe përgjegjësitë për ZHPMBSH, afatet kohore të angazhimit dhe forma e raportimit.

8.2. Strukturat mbështetëse në nivel komunal

Roli i DKA-ve në ndihmën e shkollave për vendosjen e mekanizmave dhe praktikave efektive për ZHPM me bazë në shkolla është vendimtar. Në këtë skemë qeverisje tri-nivelesh për ZHPM, DKA-ja përfaqëson ndërlidhjen mes shkollave dhe institucioneve të nivelit qendror, nëpërmjet funksioneve të saj si lehtësuese, garantuese e cilësisë dhe verifikuese e procesit për ZHPMBSH.

Koordinatori Komunal për Sigurim të Cilësisë & Koordinatori për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve:

Drejtoritë Komunale të Arsimit, në bazë të UA 24/2016 për Sigurimin e cilësisë në arsimin parauniversitar kanë përgjegjësinë që të përzgjedhin një zyrtar arsimor në këtë pozitë. Gjithashtu, DKA kanë struktura dhe organizime që lidhen me specifikat e DKA-s, që nënkupton se DKA-të kanë të drejtë të kenë edhe pozita si Koordinator komunal i zhvillimit profesional.

Shkollat për ZHPMBSH duhet të kenë DKA-në pikë kryesore mbështetëse, përkatësisht personin e caktuar nga DKA që ka përgjegjësi për planifikimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve të zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivel komunal. Kjo është në përputhje me dispozitat ligjore që mbajnë përgjegjësitë e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në nivelin komunal. Planifikimi i zhvillimit

profesional të mësimdhënësve në komunën përkatëse (bazuar në nevojat e mësimdhënësve të identifikuar në nivel shkolle) është një nga detyrat kryesore të koordinatorëve.

Bashkëpunimi ndërmjet koordinatorit komunal dhe shkollës bëhet përmes mbështetjes teknike (për shembull, sigurimi i materialeve dhe lokaleve për zhvillim profesional sipas nevojës), shërbimeve profesionale (trajnimi i fasilituesve, lehtësimi në organizimin e forumeve të këmbimit midis shkollave, identifikimi i praktikave të mira ZHPMBSH, etj.), dhe monitorimit të cilësisë së ZHPMBSH.

Në raste të caktuara, koordinatori luan rolin e verifikimit, monitorimit, vlerësimit të ZHPBSH, si dhe në rastet kur ka përgjegjësi edhe për nënshkrimin e certifikatave për mësimdhënës me rastin e përfundimit të programeve të trajnimit dhe aktiviteteve të caktuara të zhvillimit profesional që lidhen me rolin e DKA-ve, siç përshkruhet UA që rregullon ZHPMBSH.

Ekipi Komunal për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve:

Ekipi komunal për ZHPM është një ekip ekspertësh/ trajnerësh, të cilët emërohen nga DKA-ja për të ofruar aktivitete të ZHPM, bazuar në planin e DKA-ve për ZHPM ose sipas kërkesës së shkollave. Përbërja e këtyre ekipeve duhet gjithashtu të bazohet në planin e DKA-ve për ZHPM në mënyrë që të adresojë nevojat e mësimdhënësve për aktivitetet e ZHP.

Autoritetet arsimore komunale duhet të sigurojnë një mjedis i cili u mundëson të gjitha shkollave realizimin e qëllimeve të ZHPBSH.

Në anën tjetër, shkollat duhet t'i përgjigjen bashkëpunimit me DKA, iniciativave të DKA-së për zhvillim profesional, të kërkojnë mbështetje nga DKA kur është e nevojshme, si dhe të promovojnë punën e tyre ZHPMBSH në aktivitetet vjetore që organizohen nga DKA.

8.3. Strukturat mbështetëse në nivel qendror

Strukturat mbështetëse në nivel qendror janë: MASHTI, KSHLM, Inspektorati i Arsimit dhe Instituti Pedagogjik i Kosovës. Roli kryesor i autoriteteve të arsimit të nivelit qendror në mbështetjen e themelimit dhe konsolidimit të ZHPM me bazë në shkollë është përmes sigurimit të një mjedisi të përshtatshëm për funksionimin dhe

qëndrueshmërinë e këtyre mekanizmave në nivel shkolle. Përmes procedurave të jashtme të lartpërmendura pritet të vërtetojnë dhe pranojnë angazhimin e mësimdhënësve për zhvillim personal profesional, të japin informacion të besueshëm, të sigurojnë mbështetje adekuate për ZHP me bazë në shkollë dhe të sigurojnë cilësi dhe të avancojnë aktivitetet e ZHPM me bazë në shkollë duke kontribuar në edukimin dhe proceset zhvillimore të shkollës.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Detyrat kryesore të MASHTI-t në mbështetje të ZHPM me bazë në shkollë, përfshijnë:

- ▶ Zbërthimin e kompetencave të mësimdhënësve në kritere cilësore dhe tregues të matshëm që do të udhëzonin punën e mësimdhënësve, por gjithashtu vlerësimin e tyre të performancës dhe vlerësimin e nevojave;
- ▶ Ofrimin e udhëzimeve, mjeteve dhe materialeve shtesë për mësimdhënësit si dokumente burimore për ZHPM në nivel shkolle, në mënyrë që ata të mund të kuptojnë, të përvetësojnë dhe të zbatojnë qasjen e kompetencës;
- ▶ Përgatitjen e kompetencave të mësimdhënësve në programe specifike të zhvillimit të kompetencave për institucionet e arsimit të mësimdhënësve dhe ofruesit e tjerë të programeve të ZHPM në mënyrë që shkollat/ komunat të kenë zgjedhje të përshtatshme për përzgjedhjen e aktiviteteve të ZHPM;
- ▶ Sigurimin e buxhetit për aktivitetet e zhvillimit profesional nëpërmjet një linje specifike buxhetore;
- ▶ Sigurohen që zhvillimi profesional me bazë në shkollë është i akredituar dhe i pranuar për të përmbushur kërkesat e licencimit.

Inspektorati i Arsimit

Detyrat kryesore të Inspektoratit të Arsimit të MASHT-it përfshijnë:

- ▶ Monitorimin dhe verifikimin e ZHPM me bazë në shkollë (performanca e strukturave mbështetëse të ZHPM në nivel shkolle, planifikimi dhe zbatimi i aktiviteteve të ZHPM) me qëllim të ofrimit të informacionit të besueshëm dhe të detajuar që do të mbështeste shkollat në zbatimin efektiv të ZHPMBSH;

- ▶ Vlerësimin e ZHPM me bazë në shkollë, si pjesë e vlerësimit të jashtëm të shkollave, për t'u ofruar atyre komente të duhura për përmirësimin/ avancimin e aktiviteteve të tyre të ZHPMBSH.

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Funksioni kryesor i IPK-së është të ofrojë ndihmë të drejtpërdrejtë profesionale për shkollat, DKA-të, MASHTI-n ose IA-në në kryerjen e detyrave të tyre, sipas kërkesave specifike të bëra nga MASHTI ose DKA-të. Në fushën e zhvillimit profesional mund të kenë rol në procedurat e jashtme për përkrahje të zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë ZHPBSH, me theks të veçantë për mbështetje, monitorim dhe vlerësim të ZHPMBSH.

Sa i përket strukturave mbështetëse në nivel qendror për ZHPBSH, udhëheqja e shkollës duhet të sigurohet që:

Është shumë e rëndësishme që shkolla të njohë këto struktura, të vendosë kontaktet e bashkëpunimit, të iniciojë komunikimin dhe bashkëpunimin për mundësitë dhe nevojat e mbështetjes, por edhe për promovimin e punës së saj në ngjarje të rëndësishme për ZHPMBSH.

Shtojcat: Instrumentet për realizimin e ZHPMBSH

Shtojca 1: Pyetësor për vlerësimin e nevojave të zhvillimit profesional të mësimeve

I/e nderuar mësues/e,

Shkolla jonë ka filluar hartimin e planit për zhvillim profesional të mësimeve me bazë në shkollë. Duke dashur që më së miri të vlerësohen dhe të adresohen nevojat e juaja për zhvillim profesional me bazë në shkollë, ju lutemi ta plotësoni këtë pyetësor⁸.

Pyetësorin e plotësuar ju lusim ta ktheni te drejtori i shkollës, më së largu 5 ditë nga dita e pranimit.

1. Emri dhe Mbiemri: _____

2. Gjinia: (1) ☐ Mashkull (2) ☐ Femër

3. Mosha: (1) ☐ Nën 25 (2) ☐ 25 – 30 (3) ☐ 30 – 40 (4) ☐ 40 – 50 (5) ☐

Mbi 50

4. Lënda/ët që ligjëroni: _____

5. Kualifikimi juaj (zgjidhni nga opsionet):

(1) ☐ Shkollë e Lartë Pedagogjike

(2) ☐ Shkollim universitar 4 vjeçar

(3) ☐ Shkollim universitar (niveli bachelor)

(4) ☐ Master

(5) ☐ Tjetër _____

⁸ Pyetësori është marrë dhe adaptuar nga Korniza për ngritjen profesionale me bazë në shkollë e hartuar nga MASHT dhe BEP

6. Vitet e përvojë në mësimdhënie:

(1) ☐ Nën 1 vit (2) ☐ 1 – 3 v. (3) ☐ 3 – 5 v. (4) ☐ 5 – 10 v. (5) ☐ Mbi 10 v.

7. Trajnimet që keni ndjekur deri tani (emri i kursit ose tema/fusha):

a. _____

b. _____

c. _____

d.

8. Ju lutemi të vlerësoni temat e trajnimit më poshtë sipas rëndësisë/dobisë për ju dhe punën tuaj në të ardhmen:

1 = aspak 2 = pak 3 = deri diku 4 = shumë

Nr.	Temat	1	2	3	4
8.1	Korniza e Re e Kurrikulës dhe implikimet në klasë (Mësimdhënia dhe vlerësimi i bazuar në kompetenca; mësimdhënia e integruar e shkencave etj)	☐	☐	☐	☐
8.2	Stilet e të mësuarit (mënyrat si mësojnë nxënësit)	☐	☐	☐	☐
8.3	Planifikimi i orës mësimore	☐	☐	☐	☐
8.4	Të mësuarit e bazuar në projekte	☐	☐	☐	☐
8.5	Mësimi i diferencuar/individualizuar	☐	☐	☐	☐
8.6	Zhvillimi i mendimit kritik te nxënësit	☐	☐	☐	☐
8.7	Hulumtimi në klasë	☐	☐	☐	☐
8.8	Metodologjitë në lëndë përkatëse	☐	☐	☐	☐

8.9	Strategjitë moderne të mësimdhënies	☐	☐	☐	☐
8.10	Puna me nxënës që kanë vështirësi në lexim dhe shkrim	☐	☐	☐	☐
8.11	Trajnim bazik për shkathtësitë e përdorimit të Teknologjisë Informative si p.sh. Microsoft Office (Word, Excel, Access, Power Point)	☐	☐	☐	☐
8.12	Shfrytëzimi i teknologjisë në klasë	☐	☐	☐	☐
8.13	Bashkëpunimi me prindërit dhe komunitetin	☐	☐	☐	☐

9. Tregoni nevojat shtesë të zhvillimit profesional që nuk janë përfshirë më lart:

10. Ju lutemi vlerësoni format e zhvillimit profesional, sipas dobisë për ju:

1 = aspak 2 = pak 3= deri diku 4= shumë

	Formati	1	2	3	4
10.1	Mentorimi dhe këshillimi në vendin e punës	☐	☐	☐	☐
10.2	Seanca të zhvillimit profesional brenda shkollës	☐	☐	☐	☐
10.3	Pjesëmarrja në punëtori gjatë fundjavës në komunë	☐	☐	☐	☐
10.4	Pjesëmarrja në punëtori gjatë fundjavës në rajon	☐	☐	☐	☐
10.5	Studimi i materialeve të ndryshme për zhvillimin e arsimit (si kurrikula, trajnimi i mësimeve, etj.)	☐	☐	☐	☐
10.6	Pjesëmarrja në konferenca të ndryshme	☐	☐	☐	☐
10.7	Kurse/seanca nga distanca përmes internetit	☐	☐	☐	☐
10.8	Shkëmbimi i përvojave me mësimeve tjerë në shkollë	☐	☐	☐	☐
10.9	Shkëmbimi i përvojave me mësimeve tjerë e shkollave tjera	☐	☐	☐	☐

11. Ndonjë koment shtesë lidhur me nevojat e zhvillimit profesional dhe aspektet që do ta përmirësonin cilësinë e mësimdhënies tuaj:

Ju faleminderit!

Shtojca 2: Model i një plani individual për zhvillim profesional me bazë në shkollë

Përshkrim i shkurtër/ nevojat dhe arsyeshmëria

Aktiviteti i zhvillimit profesional me bazë në shkollë	Përshkrimi i aktivitetit	Mënyra e realizimit (pjesëmarrje, fasilitim, mentorim, prezantim...)	Koha e planifikuar e realizimit	Numri i orëve	Dëshmitë

Shtojca 3: Model i Planit vjetor të zhvillimit profesional me bazë në shkollë

Të dhëna hyrëse për procesin e hartimit të planit, arsyetimi dhe qëllimi

Prioritetet për ZHP dhe objektivat e zbërthyera sipas prioriteteve

Prioritetet	Aktivitetet sipas prioriteteve	Modalitet e të realizimit (Punëtori, trajnim, vëzhgim, mentorim, ligjërata..)	Personat përgjegjës		Afatet kohore												Burimet e nevojshme (njerëz, resurse materiale dhe financiare, pajisje etj.)	Mënyra e verifikimit/ dokumenti për realizimin e aktiviteve	Treguesit e realizimit të prioriteteve të ZHPBSH
			Kush do ta bëjë këtë?	Njësitë përkrahëse	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik			

Shtojca 4: Model për shënime përmbledhëse të një takimi për aktivitetet e zhvillimit profesional, të ekipit për ZHPMBSH, të grupit të kolegëve

Data: _____

Vendi: _____

Pjesëmarrësit (lista e bashkangjitur)

Tema e trajtimit/problemi i paraqitur:

Rekomandime nga pjesëmarrësit

NN:

NN:

NN:

NN:

NN:

Takime të ardhshme:

Çfarë duhet të marrim parasysh për një sesion të ardhshëm më frytdhënës?

Shtojca 5: Formë reflektimi për marrëdhënien e mentorimit dhe të mentoruarit

Pyetje për reflektim për mentorët dhe të mentoruarit ⁹
Aspektet e marrëdhënies sonë që po funksionojnë mirë janë:
Marrëdhënia jonë mund të përmirësohet nëse:
Unë kam nevojë për më shumë (për të mentoruarin):
Unë kam nevojë për më pak (për të mentoruarin):
Ajo që ka qenë më e dobishmja për mua është (për të mentoruarin):
Ajo që ka qenë më pak e dobishme për mua është (për të mentoruarin):
Cilësia dhe shpeshtësia e komunikimit tonë është:
Fushat shtesë të reflektimit për mentorët
Në çfarë aspekti po shënohet progres?
A po shtron pyetje të mira i mentoruari dhe a po tregon reflektim personal?
Çfarë mbështetje shtesë, udhëzime, sfida ose përvoja do të mund të përfitonte i mentoruari tani?
Komente ose vërejtje shtesë

⁹ Përdorni pyetjet më poshtë për të reflektuar dhe shënuar në tabelë vetëm përfundimet e dakorduara

Shtojca 6: Udhëzuesi para vëzhgimit¹⁰

Emri i mësimdhënësit: _____

Emri i vëzhguesit: _____

Data e vëzhgimit: _____ Koha e vëzhgimit: _____

Vendi: _____ Klasa: _____

SHËNIME PËR TAKIMIN PARA VËZHGIMIT:

Përshkrimi i dhomës/klasës:

Përshkrimi i nxënësve:

Tema e orës:

Rezultatet e kompetencave të synuara (RNK):

1. _____

2. _____

Rezultatet e orës: (Çka do të jenë në gjendje të bëjnë/ të dinë nxënësit në fund të orës?):

1. _____

2. _____

Strategjitë/metodat e mësimdhënies: (Çfarë strategjish/ metodash do të përdorni për të ndihmuar nxënësit që t'i arrijnë këto rezultate?):

1. _____

2. _____

¹⁰ Bazuar në: MASHT/EU-SWAP, 2012: Doracaku për mentorimin e mësimdhënësve.

3. _____

Mjetet e vlerësimit: (Si do të tregojnë se nxënësit e dinë dhe se mund ta bëjnë atë që ju prisni nga ata?):

Bregat/ përqendrimi i mësimdhënësit (Në çka do të donit të përqendrohej më shumë vëzhguesi?):

Takimi pas vëzhgimit:

Data: _____

Koha: _____

Vendi: _____

Shtojca 7: Procesi i mentorimit – përmbledhje e diskutimit pas vëzhgimit

Emri i mësimdhënësit: _____

Emri i mentorit/vëzhguesit: _____

Data e realizimit të vëzhgimit: _____ Koha e vëzhgimit: _____

Vendi i organizimit të takimit pas vëzhgimit:

Komponenti i vëzhguar:

Fokusi i vëzhgimit:

Përmbledhje e informatave kthyes nga mentori/vëzhguesi¹¹	Përmbledhje e vetë reflektimeve nga mësimdhënësi
Informatat kthyes të bazuara në punën e mësimdhënësit	Të arriturat dhe vështirësitë gjatë kryerjes së aktiviteteve të planifikuara
Aspektet për të cilat nevojitet zhvillim i mëtutjeshëm:	Aspektet për të cilat nevojitet zhvillim i mëtutjeshëm:

¹¹ Informatat kthyes nga mentori mbështeten në të dhënat përshkruese të evidentuara gjatë vëzhgimit, të cilat ofrojnë një pasqyrë të sjelljes në klasë dhe të ndërveprimit apo të ndonjë aspekti tjetër të vëzhguar, pa bërë ndonjë përpjekje për t'i gjykuar këto ngjarje si të mira apo të këqija, të drejta apo të gabuara, të efektshme apo të paefektshme.

Hapat e mëtejme/ veprimet për zhvillim dhe avancim të komponentit të vëzhguar (p.sh. planifikimi mësimor, menaxhimi i klasës, vlerësimi, përdorimi i teknologjisë, etj.):

Shtojca 8: Formë e raportit përmbledhës nga trajnimet/ punëtoritë për ZHPBSH

Vendi/shkolla:

Data:

Hyrje

1. Qëllimi i organizimit të aktivitetit, trajnimit, takimit apo punëtorisë:
2. Rrjedha e organizimit (kohëzgjatja, numri i pjesëmarrësve, aspekte organizative, etj.):
3. Temat e trajtuara:

Përmbledhje e raportit të aktivitetit kryesor (trajnimit, punëtorisë, takimit...)

1. Cilat janë rezultatet/ produktet e aktivitetit të realizuar lidhur me?
Çfarë është arritur?
2. Cilat janë mësimet kryesore që mund të ndahen me anëtarët e ekipit profesional në nivel të komunës?
3. Cilat kanë qenë vështirësitë/sfidat që i keni hasur gjatë mbështetjes dhe si janë tejkaluar? Çka duhet pasur kujdes në takimet, punëtoritë dhe format tjera të mbështetjes?

Sugjerime, rekomandime për të ardhmen dhe informacione shtesë

1. Rezultatet që priten të zhvillohen pas mbështetjes:
2. Rekomandimet për përkrahje të mëtejshme:
3. Komente dhe informacione shtesë

Shtojcat

(Agjenda, lista e pjesëmarrjes, foto)

Shtojca 9: Formë e raportit përmbledhës nga takimet mentoruese në nivel shkolle

Mentori:

Data:

Qëllimi i mentorimit:

Pjesëmarrës në takime mentoruese:

Temat e diskutuara/trajtuara/ apo vëzhguara gjatë mentorimit:

Metodologjia e mentorimit:

Disa informata kthyesë të dhëna gjatë procesit të mentorimit:

Përmbledhje e raportit të takimeve mentoruese

- Progresi i arritur në zbatimin e përvojave të trajnimit para mbështetjes:
- Rezultatet që priten të zhvillohen pas mbështetjes së ofruar:
- Rekomandimet për përkrahje të mëtejshme:
- Komente dhe informacione shtesë:

Shtojca 10: Formulari i monitorimit të brendshëm të trajnimeve dhe aktiviteteve të ZHPMBSH¹²

INFORMATAT BAZË				
Data:				
Punëtorja / Trajnimi / Tema:				
1. Kushtet e përgjithshme të trajnimit	Jo	Deri diku	Po, në pjesën më të madhe	Po, plotësisht
1.1. Është bërë informimi me kohë në lidhje me kohën e mbajtjes së trajnimit				
1.2. Salla ku mbahet trajnimi i plotëson kushtet bazë për trajnim.				
1.3. Vijuesit e trajnimit janë informuar me agjendën e trajnimit.				
2. Fasilituesit/Trajnerët, efikasiteti dhe efektiviteti	Jo	Deri diku	Po, në pjesën më të madhe	Po, plotësisht
2.1. Fasilituesit/Trajnerët kanë prezentuar në fillim të trajnimit rezultatet/qëllimet e trajnimit.				
2.2. Fasilituesit/Trajnerët kanë qenë kompetentë në fushën që kanë ligjëruar.				
2.3. Fasilituesit/Trajnerët kanë zgjuar interesimin e pjesëmarrësve gjatë trajnimit.				
2.4. Fasilituesit/Trajnerët kanë nxitur që pjesëmarrësit të bëjnë pyetje dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në trajnim.				
2.5. Fasilituesit/Trajnerët kanë qenë të qartë në prezantimet e bëra.				
2.6. Fasilituesit/Trajnerët kanë ofruar mjaftueshëm shembuj që lidhen me përmbajtjen e trajtuar gjatë sesioneve.				
2.7. Fasilituesit/Trajnerët kanë përdorur metoda interaktive të trajnimit.				

¹² Përshtatur nga modeli i GIZ-it për monitorimin e programeve të trajnimit që ofrohen nga GIZ.

2.8.Fasilituesit/Trajnerët i kanë kushtuar vëmendje të duhur punës në çifte, grupe.				
2.9.Fasilituesit/Trajnerët kanë dhënë përgjigje të duhura në pyetjet e pjesëmarrësve.				
2.10. Fasilituesit/Trajnerët e kanë respektuar agjendën.				
3. PËRSHTYPJET E PËRGJITHSHME MBI TRAJNIMIN	Jo	Deri diku	Po, në pjesën më të madhe	Po, plotësisht
3.1. Punësoria/trajnimi ka arritur t'i përmbushë rezultatet/qëllimet që i ka paraparë.				
3.2. Materialet e përpunuara në këtë trajnim mund të përdoren në praktikën e klasës.				
3.3. Pjesa teorike dhe praktike është ndarë si duhet.				

Shtojca 11: Programet/fushat e zhvillimit profesional sipas Kornizës Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve

Programet/fushat e zhvillimit profesional¹³			
	Orët e zhvillimit profesional	Programet/fushat themelore të MASHT-it	Zhvillim profesional me bazë në shkollë
Para shërbim/faza hyrëse			
Para shërbim	5 vjet, duke përfshirë xx javë të praktikës në shkollë	Shkollimi para shërbimit në institucionet e shkollimit të mësimdhënësve	Duhet të përfshihen sesione të mikro-mësimdhënies dhe vrojtime në klasë nëpër shkolla si pjesë e punës studimore
Faza hyrëse	20-40 orë gjatë 1-2 vjetësh në fushën e mësimi	Programet e zhvillimit profesional në këtë nivel duhet të fokusohen në: - zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca; - zgjerimin e njohurive lëndore; - përmbajtje dhe metoda pedagogjike; - menaxhim klase; - vlerësimin e nxënësve; - planifikimin e orës mësimore; - ndihmën dhe motivimin e nxënësve; - përgjegjësitë dhe të drejtat	Mbështetje në nivel shkolle duke përfshirë lidhjen e mësimdhënësve të rinj me mësimdhënësit me përvojë dhe me aktivet profesionale.

¹³ Programet e zhvillimit profesional për mësimdhënës në edukimin parashkollor, mësimdhënës gjithëpërfshirës dhe mësimdhënës në AAP, duhet ti referohen nevojave, kërkesave dhe specifikave të mësimdhënies në këto institucione.

		profesionale të mësimdhënësve, etj.	
Në shërbim			
Mësimdhënësi i karrierës	100 orë të mësimit profesional	Programet e zhvillimit profesional në këtë nivel duhet të fokusohen në: - zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca - përmbajtje dhe metoda pedagogjike; - shkathtësi të mendimit kritik; - shfrytëzimin e teknologjisë në procesin mësimor; - menaxhimin e klasës; - vlerësimin e nxënësve; - planifikimin e orës mësimore; - ndihmën dhe motivimin e nxënësve; - përgjegjësitë dhe të drejtat profesionale të mësimdhënësve; - punën me prindër; - mentorimin dhe trajnimin, etj.	Zhvillim profesional i identifikuar nga mësimdhënësi, dhe përfshin zhvillimin profesional me bazë shkolle/punën në aktivet profesionale
Mësimdhënësi i avancuar	300 orë të zhvillimit profesional	Programet e zhvillimit profesional në këtë nivel duhet të fokusohen në: - zbatimin e kurrikulës së re të bazuar në kompetenca - përmbajtje dhe metoda pedagogjike; - shkathtësi të mendimit kritik; - shfrytëzimin e teknologjisë në procesin mësimor; - menaxhimin e klasës; - vlerësimin e nxënësve; - planifikimin e orës mësimore; - ndihmën dhe motivimin e	Zhvillim profesional i identifikuar nga mësimdhënësi, dhe përfshin zhvillimin profesional me bazë shkolle/punën në aktivet profesionale

		nxënësve; - përgjegjësitë dhe të drejtat profesionale të mësimeve; - punën me prindër; - mentorimin dhe trajnimin, etj.	
Mësime mentore	200 orë të zhvillimit profesional	Programet e zhvillimit profesional në këtë nivel duhet të fokusohen në: - përmbajtje dhe metoda pedagogjike; - shkathtësi të mendimit kritik; - shfrytëzimin e teknologjisë në procesin mësimor; - shkathtësi të mentorimit, trajnimit dhe monitorimit; - menaxhimin e klasës; - vlerësimin e nxënësve; - planifikimin e orës mësimore; - ndihmën dhe motivimin e nxënësve; - punën me prindër; - Etj.	Zhvillim profesional i identifikuar nga mësimeve, dhe përfshin zhvillimin profesional me bazë shkolle/punën në aktivet profesionale
Mësime meritor	450 orë të zhvillimit profesional	Programet e zhvillimit profesional në këtë nivel duhet të fokusohen në: - Shkathtësi për trajnime, mentorim, këshillim; udhëheqje arsimore; - Trajnim për koordinator të cilësisë; - Zhvillim të kurrikulës; - Etj.	Deri në 6 orë të zhvillimit profesional të identifikuar nga mësimeve, dhe përfshin zhvillimin profesional me bazë shkolle/punën në aktivet profesionale

Shtojca 12: Model i formularit për hartimin e programit të trajnimit nga shkolla për ZHPMBSH¹⁴

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR SHKOLLËN

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN

Titulli i Programit të Trajnimit për ZHPMBSH:

Të dhënat për trajnerët e programit:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Kualifikimi	Përvoja në mësimdhënie	Vitet e përvojës në cilësinë e trajnerit në programet e trajnimit për mësimdhënës
1				
2				

Grupi i synuar i mësimdhënësve që do të marrin pjesë në programin e trajnimit me bazë në shkollë:

Numri i orëve të programit trajnues (numri i orëve të trajnimit, mentorimit dhe detyrave praktike)

DETAJET E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

Përvoja e zhvillimit të programit të trajnimit

Rezultatet e programit

¹⁴ Formulari mbështetet në modelin e publikuar nga KSHLM për ofruesit e jashtëm të programeve të trajnimit.

Përmbajtja e programit dhe aktivitetet qe sigurojnë arritjen e rezultateve të programit
Materialet e trajnimit
Metodologjia që do të përdoret në ofrimin e programit trajnues
Sigurimi i cilësisë së programit të trajnimit:

Shtojca 13: Model i certifikatës për ZHPMBSH

 Logo e komunës		 Logo e shkollës
CERTIFIKATË E ZHVILLIMIT PROFESIONAL TË MËSIMDHËNËSVE ME BAZË NË SHKOLLË për znj/z. _____ për pjesëmarrje dhe përfundim të suksesshëm të PROGRAMIT DHE AKTIVITETEVE TË ZHVILLIMIT PROFESIONAL ME BAZË NË SHKOLLË TË PLANIFIKUARA PËR VITIN SHKOLLOR _____		
N.N. Drejt看 i shkollës		N.N. Trajner/ koordinator i cilësisë
(Vendi _____, data dhe viti _____)		

Programi dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë për vitin shkollor _____, janë miratuar nga KDSH me _____.

Programi dhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimeve me bazë në shkollë në të cilat mësuesi/ja _____ ka qenë i/e përfshirë dhe i ka përmbushur me sukses kërkesat për certifikim, janë si në vijim:

1. _____
(orë _____)
2. _____
(orë _____)
3. _____
(orë _____)
4. _____
(orë _____)
5. _____
(orë _____)

Mësuesi/ja _____ gjatë këtij viti ka arritur gjithsej _____ orë të zhvillimit profesional me bazë në shkollë, të cilat mund të dëshmohen në sistemin e licencimit të mësimeve dhe për qëllime të tjera që lidhen me zhvillimin në karrierë të mësimeve.

(Vendi _____, data dhe viti _____)

Referencat & dokumente, doracak/udhëzues dhe burime të përdorura për këtë udhëzues dhe të dobishme për zhvillimin profesional me bazë në shkollë.

- ▶ Devetaku, H. (2018). Doracaku për Aktivitet Profesional në shkollat e Kosovës – roli dhe funksioni i tyre (GIZ, 2018);
- ▶ EU Projekti: Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve (2019). Moduli: Planifikimi mësimor për zbatimin e kurrikulës. Zbatuar nga: Planet, Sofreco dhe WUS Austria.
- ▶ EU Projekti: Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve (2019). Moduli: Vlerësimi i nxënësve. Zbatuar nga: Planet, Sofreco dhe WUS Austria.
- ▶ EU Projekti: Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve (2019). Moduli: Mentorimi me bazë në shkollë. Zbatuar nga: Planet, Sofreco dhe WUS Austria.
- ▶ Goddard, J. T., dhe Buleshkaj, O. (2018). Drejt një modeli të ri të integruar dhe të bazuar në shkollë të Zhvillimit Profesional dhe të Karrierës së Mësimdhënësve në Kosovë. Konceptdokument i pabotuar dhe i përgatitur për Projektin e Përmirësimit të Sistemit të Arsimit (ESIP). Prishtinë, Kosovë: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
- ▶ Instituti Pedagogjik i Kosovës, (2016), Udhëzues për udhëheqjen e zbatimit të kurrikulës në shkollë, Prishtinë, <https://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2017/03/Udhëzuesi-për-zbatim-të-kurrikulës1.pdf>,
- ▶ Mehmeti, S., Boshtrakaj, L., Bytyqi, L. Zylfiu, H. & Potera, I. (2018). Përvojat e para në vlerësimin e performancës së shkollës. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë. <http://ipkmasht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/11/Raporti-Përvojat-e-para-në-vlerësimin-e-performancës-së-shkollës.pdf>
- ▶ Mehmeti, S., Bytyqi, L., Zylfiu, H. & Potera, I. (2019). Kurrikula e bazuar në kompetenca - Përvojat gjatë zbatimit, sfidat dhe mundësitë si dhe nevojat për mbështetje të vazhdueshme të mësimdhënësve. Instituti Pedagogjik i Kosovës, Prishtinë.

- ▶ Mehmeti, S., Zylfiu, H., Potera, I., Buleshkaj, O. & Ulrike Lehner (2016). Manual për sigurim të cilësisë në shkollë. MASHT. Përgatitur me përkrahje të KulturKontakt Austria në kuadër të Projektit të Binjakëzimit.
- ▶ Mentor Professional Development, Alabama teacher induction and mentoring manual.
- ▶ Mentoring Program Manual, <http://cmcismentorprogram.wordpress.com>
- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016), Kuadri për Sigurimin e Cilësisë së Performancës së Shkollave
- ▶ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2016), Plani Strategjik i Arsimit të Kosovës 2017-2021
- ▶ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2017), Udhëzimi administrativ nr. 06/2017 për Kriteret dhe Procedurat e Aprovimit të Programeve për Zhvillimin Profesional të Mësimdhënësve dhe Punëtorëve Arsimor
- ▶ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2017), Udhëzimi administrativ 04/2017 për Vlerësimin e Performancës së Institucioneve Arsimore në Arsimin Parauniversitar
- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/04/kornizë-strategjike.pdf>
- ▶ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2017). Udhëzimi administrativ nr. 05/2017 Sistemi i Licencimit dhe Zhvillimi i Mësimdhënësve në Karrierë
- ▶ Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Udhëzimi administrativ nr. 14/2018 mbi Vlerësimin e Performancës së Mësimdhënësve
- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Udhërrëfyesi për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, Prishtinë <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/udhërrëfyes-për-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>
- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2016). Udhëzimi administrativ për aktivet profesionale (departamentet), të shkollave, Prishtinë, <https://masht.rks-gov.net/udhëzimet-administrative-2016>,

- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.(2012). Doracak për mentorimin e mësimeve. Përgatitur me përkrahje të Bashkimit Evropian.
- ▶ Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.(2016). *Korniza e Kurrikulës e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës* (e rishikuar). Prishtinë. <http://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>
- ▶ Vula, E., Berisha, F., Kida, E., Shatri, K, Buza, K. & A.Fitore (2011). Moduli 2 për trajnimin e mësimeve: Mentorimi i mësimeve. MASHT. Përgatitur me përkrahje të Bashkimit Evropian në kuadër të projektit IPA 2009.
- ▶ <https://englishagenda.britishcouncil.org/continuing-professional-development/teacher-educator-framework/supporting-and-mentoring-teachers/introduction-supporting-and-mentoring-teachers>